



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr.08/2023
PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË MARKAVE TREGTARE

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Në mbështetje të nenit 93 paragrafi 1 të Ligji Nr. 08/L- 075 për Markat Tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/13 Korrik 2022, nenit 11 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, Shtojca 12 e Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenin 38, paragrafi 6 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) NR. 08 /2023 PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË MARKAVE TREGTARE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ përcakton procedurat për regjistrimin e markës tregtare në Agjencinë për Pronësi Industriale, (në tekstin e mëtejme – Agjencia).

Neni 2 Fushëveprimi

Ky udhëzim administrativ zbatohet për subjektet që i nënshtrohen procedurës së regjistrimit për fitimin e markës tregtare në Agjencinë për Pronësi Industriale.

KAPITULLI II APLIKACIONI PËR REGJISTRIMIN E MARKËS TREGTARE

Neni 3 Përmbajtja e aplikacionit

1. Aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare përmban:

1.1. kërkesën për regjistrimin e markës tregtare;

1.2. të dhënat për paraqitësin - pronarin e aplikacionit. Nëse paraqitësi i aplikacionit është person fizik ose juridik: Emri dhe mbiemri i aplikuesit ose emri i kompanisë, adresa e plotë, adresa elektronike dhe numri i telefonit. Nëse përfaqësuesi është person fizik ose juridik: emri dhe mbiemri i aplikuesit ose emri i kompanisë, adresa e plotë, adresa elektronike dhe numri i telefonit;

- 1.3. numrin e klasave në listën e produkteve dhe/ose shërbimeve për të cilat kërkohet regjistrimi i markës; mallrat dhe/ose shërbimet duhet të ceken në rubrikën e posaçme në aplikacion në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar për Mallrat dhe Shërbimet (Klasifikimi i Nicës);
- 1.4. nëse kërkohet e drejta e përparësisë, të dhënat sipas nenit 27 të Ligjit për Markat Tregtare;
- 1.5. nëse kërkohet e drejta e përparësisë nga ekspozita, të dhënat përkatëse të ekspozitës së parë, sipas nenit 29 të Ligjit për Markat Tregtare;
- 1.6. dukja dhe të dhënat për llojin e markës sipas nenit 5 paragrafi 3 të këtij Udhëzimi Administrativ, për të cilën kërkohet regjistrimi;
- 1.7. nëse shenja përmban shkronjë, fjalë apo numra që nuk janë me shkrime latine, apo numra arabe ose romak, aplikacioni shoqërohet nga një përshkrim ose transliterim i secilës prej këtyre shkronjave, fjalëve ose numrave;
- 1.8. të dhënat e qarta nëse kërkohet regjistrimi i një marke kolektive ose certifikuese;
- 1.9. nënshkrimin ose vulën e aplikuesit ose përfaqësuesit të tij.
- 1.10. deklaratë nga aplikuesi për heqje dore të çfarëdo të drejte të pretenduar në ndonjë element të markës tregtare, e cila nuk është dalluese, përkatësisht fjalët që konsiderohen të jenë gjenerike, përshkruese ose informuese.

2. Kur në aplikacion janë paraqitur dy apo me shume paraqitës të aplikacionit, atëherë duhet të caktohet njëri prej tyre si përfaqësues i përbashkët.

Neni 4

Dokumente tjera shtesë për aplikim

1. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumente tjera shtese si në vijim:

- 1.1. lista e mallrave ose shërbimeve që konsiderohet si pjesë përbërëse e aplikacionit dhe përshkrimin e listës së produkteve dhe shërbimeve sipas klasifikimit të Nicës;
- 1.2. dëshmi për të drejtën e përparësisë sipas nenit 27, paragrafi 2 ose në raste kur kërkohet, të drejtën e përparësisë së ekspozitës sipas nenit 29 paragrafit 2 të Ligjit për markat tregtare;
- 1.3. rregulloren sipas nenit 61 të Ligjit për Marka Tregtare;
- 1.4. dëshminë e pagesës së taksës përkatëse;
- 1.5. autorizimin e përfaqësimit;
- 1.6. përshkrimin e shenjës;
- 1.7. përkthimin e shenjës në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës nëse shenja përbëhet ose përmban një ose më shumë fjalë nga ndonjë gjuhë tjetër.

Neni 5

Dukja e markës tregtare

1. Dukja e Markës tregtare duhet të paraqitet në aplikacion në mënyrë të qartë, të saktë, të veçant, të kuptueshme dhe objektiv, në formë të përshtatshme duke përdorur teknologji të disponueshme, si dhe në formë elektronike, me kusht që dukja të jetë në gjendje të paraqitet në regjistrin elektronik të Agjencisë.

2. Dukja e markës tregtare definojnë objektin apo lëndën e regjistrimit. Nëse një përshkrim shoqëron dukjen, përshkrimi i tillë duhet të përputhet me dukjen dhe nuk mund të zgjerohet vëllimin e regjistrimit të kërkuar.

3. Kur aplikacioni ka të bëjë me çfarëdo lloji të markës tregtare sipas nën-paragrafëve 3.1. deri në 3.10. të këtij paragrafi, aplikacioni përfshin të dhënat përkatëse. Dukja e një marke tregtare të paraqitur në aplikim duhet të jetë në përputhje me llojin e markës tregtare, ashtu siç është cekur në aplikacion në regjistrimin e kërkuar, si më poshtë:

3.1. kur një markë tregtare përbëhet vetëm nga fjala ose shkronja, numra, shenja të tjera tipografike standarde ose kombinime të tyre (marka tregtare verbale), dukja duhet të jetë riprodhim i një marke tregtare e cila është përdorur me mënyra standarde të shkrimit dhe renditjes, pa ndonjë element grafik apo ngjyrë të veçantë;

3.2. në rastet kur marka tregtare përbëhet me karaktere jo standarde, stilizime, renditje të karaktereve/shenjave, elemente grafike ose ngjyra (marka tregtare figurative), duke përfshirë markat tregtare që përbëhen vetëm nga elemente figurative ose kombinim të elementeve verbale dhe figurative, dukja duhet të jetë një riprodhim i markës tregtare që shfaq të gjitha elementët e saj dhe, varësisht prej rastiit, edhe ngjyrat; dukja paraqitet në aplikacion në mënyrë elektronike, në vendin e përcaktuar në aplikacion;

3.3. kur një markë tregtare ka formë tre-dimensionale, duke përfshirë ambalazhin, paketimin, vetë produktin ose pamjen e tyre (marka tregtare tre-dimensionale), paraqitja duhet të jetë një riprodhim grafik i një forme, përfshirë imazhet e krijuara nga kompjuteri, ose riprodhimet fotografike; riprodhimet grafike ose fotografike mund të përmbajnë këndvështrime të ndryshme; paraqitja mund të përmbajë deri në gjashtë pikëpamje të ndryshme, kur një shenjë e formës paraqitet me vizatim, dizajni duhet definohet qartë me vija të zeza uniforme, të përcaktuara qartë dhe jo me vija të mjegulluara; vizatimi mund të përmbajë vija dhe nuanca për të paraqitur detaje tredimensionale;

3.4. kur një markë tregtare përdoret në mënyrë specifike në të cilën marka tregtare vendoset ose ngjitet në produkt (markë tregtare e pozicionit), paraqitja duhet të jetë një riprodhim që identifikon në mënyrë të përshtatshme pozicionin e një marke tregtare dhe madhësinë ose proporcionet e saj në raport me mallrat përkatëse, elementet që nuk përbëjnë objektin e regjistrimit ceken vizualisht, mundësisht me vija të ndërprera ose me pika, paraqitja mund të shoqërohet me një përshkrim që detajon se si është vendosur shenja në mallra;

3.5. në rastin e markave tregtare që përbëhen ekskluzivisht nga një grup elementësh që përsëriten rregullisht (një markë tregtare e modelit), paraqitja duhet të jetë një riprodhim që tregon modelin e përsëritjes, i cili mund të shoqërohet me një përshkrim që tregon se si elementet e saj përsëriten rregullisht;

3.6. në rast kur ngjyra apo ngjyrat përbëjnë ekskluzivisht një markë tregtare (markë tregtare ngjyrë) atëherë mund të paraqitet në disa dukje;

3.6.1. nëse marka tregtare përbëhet vetëm nga një ngjyrë pa kontur, dukja duhet të jetë riprodhim i ngjyrës, e cila mund të specifikohet me kodin përgjithësisht të dallueshëm të ngjyrës;

3.6.2. nëse marka tregtare përbëhet vetëm nga një kombinim i ngjyrave pa kontur, dukja duhet të jetë një riprodhim që tregon rregullimin e kombinimit të ngjyrave në një mënyrë uniforme dhe të paracaktuar, si dhe indikacion të atyre ngjyrave duke iu referuar ndonjë kodi përgjithësisht të pranuar të ngjyrave, e cila mund të shoqërohet me një përshkrim, me detaje për rregullimin e vazhdueshëm të ngjyrave;

3.6.3. në rast se një markë tregtare përbëhet vetëm nga një tingull ose kombinim të tingujve (markë tingull), paraqitja duhet të jetë regjistrim zanor i cili riprodhon një tingull të tillë ose shënim të notave të sakta të zërit;

3.6.4. në rast se një markë përbëhet ose përfshin edhe ndonjë lëvizje apo ndryshim në pozicionin e elementeve të markës tregtare (markë lëvizëse), paraqitja duhet të jetë video skedar ose një seri e pamjeve statike të njëpasnjëshme, që tregojnë lëvizjen apo ndryshimin e pozicionit; kur përdoren imazhe të palëvizshme, ato mund të numërohen apo shoqërohen me një përshkrim që shpjegon sekuencën;

3.6.5. në rastin e ndonjë marke tregtare që përbëhet ose përfshin ndonjë kombinim të imazhit dhe zërit (markë multimediale), paraqitja bëhet në një regjistrim audio-vizual që përmban kombinim të pamjes dhe zërit;

3.6.6. në rastin e ndonjë marke tregtare që përbëhet nga elemente me karakteristika holografike (markë hologrami), dukja duhet të jetë me video skedar, grafik ose riprodhim fotografik që përmban perspektiva të nevojshme për të identifikuar në masë të mjaftueshme efektin holografik në tërësinë e vet.

4. Nëse paraqitet një markë tregtare që nuk është në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, paraqitja e saj duhet të jetë në përputhje me parimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, paraqitja e tillë mund të shoqërohet me përshkrim përkatës.

Neni 6

Paraqitja elektronike e dukjes së markës

1. Paraqitja elektronike duhet të jetë në përputhje me udhëzimet për specifikacionet teknike të paraqitjes së markës tregtare dhe formatet e lejuara të dokumenteve, që gjenden në ueb faqen e Agjencisë.

2. Nëse paraqitja nuk ofrohet në mënyrë elektronike, marka tregtare riprodhohet në vendin e paraparë në formularin e aplikimit TM – 1 (katror me dimensione 8 x 8 cm).

3. Paraqitja e markës tregtare nuk duhet të përmbajë mbishkrime, fshirje, shkrim dore ose mbulim me ngjyrë.

4. Nëse kërkohet regjistrimi i ndonjë marke me ngjyrë, aplikacioni duhet të përmbajë riprodhimin e markës me ngjyrë, ndërsa ngjyrat që përbëjnë markën tregtare duhet të shënohen me fjalë në kolonën përkatëse. Përveç kësaj, mund të shtohet edhe ndonjë referencë e kodit të ngjyrave, të

njohur ndërkombëtarisht. Nëse nuk kërkohet regjistrimi i një marke me ngjyrë, marka paraqitet bardh e zi në të gjitha dokumentet, në bazat elektronike të të dhënave elektronike dhe në Buletinin Zyrtar të Agjencisë.

5. Gjatë regjistrimit në regjistrin e markave tregtare të cilin e administrojnë Agjencia, në publikimin, në vendimin për regjistrimin e markës tregtare dhe në certifikatën e markës tregtare, marka me ngjyrë shfaqet në teknologjinë më të mirë që disponon Agjencia. Në rast të ndonjë kontesti lidhur me nuancat dhe hijet e ngjyrave me të cilat paraqitet marka tregtare, riprodhimi i markës tregtare përcaktohet sipas origjinalit të markës tregtare në formularin e aplikimit.

6. Mostrat në të cilat vendoset dukja e markës tregtare për të cilën kërkohet regjistrimi, nuk konsiderohet si dukje e markës tregtare. Këto mostra i kthehen aplikuesit. Në rast se kthimi i tyre nuk është i mundur, ato asgjësohen me shpenzim të aplikuesit përpara publikimit të aplikacionit për regjistrimin e markës tregtare.

Neni 7

Lista e produkteve dhe shërbimeve

1. Produktet dhe shërbimet duhet të përcaktohen qartë dhe të klasifikohen sipas klasave të Klasifikimit të Nicës, secila klasë duhet të shënohet me numrin e klasës; në listën e produkteve dhe shërbimeve duhet të përdoren përkufizime dhe shprehje nga Lista Alfabetike e Produkteve dhe Shërbimeve sipas Klasës së Klasifikimit të Nicës.

2. Klasifikimi i produkteve dhe shërbimeve shërben ekskluzivisht për qëllime administrative dhe produktet ose shërbimet nuk mund të konsiderohen të ngjashme vetëm sepse klasifikohen në të njëjtën klasë të klasifikimit të Nicës.

Neni 8

Procedura për ekzaminimin formal të aplikacionit

1. Aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare dorëzohet në Agjenci në 2 (dy) kopje.

2. Aplikuesi mund të kërkojë regjistrimin e vetëm një shenje përmes një aplikacioni. Me një aplikacion nuk mund të kërkohet regjistrimi i dy apo më tepër shenjave.

3. Aplikacioni evidentohet me të dhëna përkatëse nga Agjencia me datën e pranimit dhe numrin e aplikacionit.

4. Agjencia i kthen paraqitësit njëzëri nga dy aplikacionet me të dhënat përkatëse të evidentuara si dëshmi të dorëzimit të aplikacionit nga ana e aplikuesit.

5. Agjencia nëse gjatë procedurës së regjistrimit, vazhdimisht vlerëson se paraqitja e shenjës ka elemente përshkruese ose tjera, atëherë këto elemente mund të përjashtojnë nga mbrojtja një ose disa elemente të shenjës së paraqitur në aplikacion për regjistrim apo ekskluziviteti i përdorimit

Neni 9

Ekzaminimi i parakohshëm i aplikacionit

1. Agjencia e bën ekzaminimin formal të aplikacioneve në renditje kronologjike, ashtu siç janë pranuar nga Agjencia.
2. Aplikuesi mund të parashtojë kërkesën për ekzaminim të parakohshëm duke iu referuar nenit 30 paragrafi 6 i Ligjit për Markat Tregtare.
3. Kërkesat që nuk janë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, nuk shqyrtohen nga Agjencia.
4. Kërkesa nga paragrafi 2. i këtij neni duhet të përmbajë arsyetimin për shqyrtim të ekzaminimit të parakohshëm. Arsyet për ekzaminim të parakohshëm do të konsiderohen të bazuara nëse ekzistojnë rrethana të pazgjdhura që varen drejtpërdrejt nga shpejtësia e procedurës së regjistrimit. Humbjet ose dëmtimet që mund të pësojë aplikuesi vetëm për shkak se marka tregtare e aplikuar nuk është ende e regjistruar nuk konsiderohen rrethana të jashtëzakonshme.
5. Kërkesës nga paragrafi 2. i këtij neni duhet t'i bashkëngjitet dëshmia e pagesës së taksës përkatëse. Agjencia nuk i merr parasysh kërkesat e parashtruara pa dëshminë e pagesës së taksës përkatëse.
6. Agjencia vazhdon procedurat e ekzaminimit të aplikimit për kërkesën sipas Ligjit për Marka Tregtare pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës. Nëse refuzohet kërkesa, njoftimi për refuzimin e kërkesës duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet të i komunikohet aplikuesit.
7. Nëse Agjencia konsideron se janë plotësuar kushtet për ekzaminim të parakohshëm sipas paragrafit 4 të këtij neni dhe se është paguar taksë përkatëse, ajo bën ekzaminimin formal dhe ekzaminimin lidhur me arsyet absolute për refuzim nga neni 6 i Ligjit për Markat Tregtare, duke zbatuar procedurën e rregulluar në nenin 30 dhe 31 të Ligjit për Markat Tregtare dhe me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 10

Procedura e ekzaminimit lidhur me refuzimin mbi bazat absolute të markës tregtare

1. Nëse Agjencia vërteton se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 30 të Ligjit për Markat Tregtare, Agjencia vazhdon me procedurat e përcaktuara nga neni 6 dhe neni 31 të Ligjit për Markat Tregtare dhe të këtij Udhëzimi Administrativ.
2. Pasi Agjencia konstaton se janë përmbushur kërkesat nga neni 30 paragrafi 1 i Ligjit për Markat Tregtare, aplikacioni i nënshtrohet procedurës së ekzaminimit për bazat të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit për Markat Tregtare.
3. Agjencia shqyrton secilën bazë të përcaktuar në nenin 6 të Ligjit për Markat Tregtare, një nga një, në mënyrë të pavarur ashtu siç janë paraqitur.

4. Pas procedurës së ekzaminimit sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, Agjencia sipas nenit 31 të Ligjit duhet të lëshoj njoftim me shkrim për shkaqet e refuzimit, duke specifikuar shkaqet dhe arsyetimet për refuzim sipas nenit 6 të Ligjit për Markat Tregtare.

5. Agjencia lëshon njoftim me shkrim për shkaqet e refuzimit të cekura në paragrafin 4 të këtij neni për disa ose për të gjitha mallrat ose shërbimet e kërkuara në aplikim.

6. Nëse Agjencia i dorëzon aplikuesit njoftimin me shkrim për shkaqet e refuzimit të cekura në paragrafin 4 të këtij neni e fton atë që në afat prej 2 muajve nga marrja e njoftimit, të paraqesë vërejtje dhe kundërgjegje duke përfshirë paraqitjen e fakteve dhe provave shtesë që mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar të Agjencisë-së lidhur me bazat absolute për refuzim të regjistrimit nga neni 6 i Ligjit për Markat Tregtare. Me kërkesën e aplikuesit, afati mund të zgjatet edhe për dy (2) muaj nga skadimi i periudhës së parë dymujore.

7. Nëse kërkesës për zgjatjen e afatit kohor në përputhje në paragrafin 6 i këtij neni nuk i bashkëngjitet dëshmia e taksës në shumë perkatese, Agjencia nuk i merr parasysh kërkesat e parashtruara pa dëshminë e pagesës së taksës përkatëse.

8. Me marrjen e njoftimit me shkrim për shkaqet e refuzimit nga paragrafi 4 i këtij neni, aplikuesi mund të tërheqë aplikacionin e tij, të kufizojë listën e mallrave dhe shërbimeve ose të paraqesë vërejtje dhe argumente lidhur me gjetjet e Agjencisë, duke përfshirë paraqitjen e fakteve, argumenteve dhe provave shtesë, që mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar të Agjencisë.

9. Nëse aplikuesi e tërheq aplikacionin, aplikacioni konsiderohet si i paparaqitur. Me kërkesë të aplikuesit, Agjencia lëshon konfirmim për tërheqjen e aplikacionit.

10. Nëse aplikuesi nuk përgjigjet afatit të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni, Agjencia nxjerrë vendim përkatës.

11. Agjencia pas pranimit të përgjigjes nga aplikuesi sipas njoftimit me shkrim për shkaqet e refuzimit të cekura në paragrafin 4 të këtij neni shqyrton të gjitha vërejtjet dhe argumentet e paraqitura nga aplikuesi dhe lëshon Vendim përkatës duke u bazuar në neni 6 të Ligjit.

12. Nëse Agjencia gjatë procedurës së ekzaminimit vlerëson se aplikacioni është dorzuar me keqbesim dhe përmban markë tregtare të mirënjohura apo me reputacion ndërkombëtar dhe të regjistruara në baza të të dhënave ndërkombëtare API refuzon aplikacionin për regjistrim.

Neni 11

Publikimi i aplikacionit dhe futja në Regjistrin e Markave Tregtare

1. Nëse aplikacioni i ka plotësuar kushtet pas shqyrtimit në baza absolute, sipas nenit 6 të Ligjit për Markat Tregtare, ai publikohet në Buletin Zyrtar të Agjencisë në përputhje me nenin 32 paragrafi 1 të Ligjit për Markat Tregtare dhe regjistrohet si aplikacion në Regjistrin e Markave Tregtare të cilin e administron Agjencia, në pajtim me nenin 71, paragrafi 1 të Ligjit për Markat Tregtare.

2. Nëse pas shqyrtimit në baza absolute sipas nenit 6 të Ligjit për Markat Tregtare, aplikacioni është refuzuar vetëm për disa mallra dhe shërbime për të cilat është paraqitur, aplikacioni publikohet në Buletinin Zyrtar të Agjencisë në përputhje me nenin 32 paragrafi 1 i Ligjit për Markat Tregtare dhe regjistrohet si aplikacion në Regjistrin e Markave Tregtare që administrohet nga Agjencisë, në përputhje me nenin 71 paragrafi 1 të Ligjit për Markat Tregtare, vetëm për mallrat dhe shërbimet të cilat nuk janë refuzuar.

3. Nëse, pas shqyrtimit në baza absolute të cekura në nenin 6 të Ligjit për Markat Tregtare, aplikacioni refuzohet për të gjitha mallrat dhe shërbimet për të cilat është paraqitur, vendimi publikohet në Buletinin Zyrtar të Agjencisë.

Neni 12

Përmbajtja e publikimit të aplikacioneve

1. Publikimi i aplikacionit në Buletinin zyrtarë të Agjencisë përmban këto të dhëna:

- 1.1. numrin e aplikacionit;
- 1.2. datën e paraqitjes të aplikacionit;
- 1.3. emrin dhe adresën e aplikuesit apo aplikuesve;
- 1.4. emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ka të tillë;
- 1.5. dukja e markës tregtare, së bashku me elementet dhe përshkrimet e cekura në nenin 4 të këtij udhëzimi administrativ,
- 1.6. listën e mallrave dhe shërbimeve të renditura sipas klasave të Klasifikimit Nices;
- 1.7. të dhënat e pretenduara lidhur me kërkesën për të drejtën e përparësisë;
- 1.8. të dhënat e pretenduara lidhur me kërkesën për të drejtën e përparësisë nga ekspozita;
- 1.9. kur aplikohet për një markë me ngjyrë, publikimi përmban indikacionin/cekjen "ngjyrë" dhe së bashku me shënimin për ngjyrat që përbëjnë markën dhe shënimin e kodit ndërkombëtar të njohur të ngjyrave;
- 1.10. të dhënat për një markë kolektive ose për markë certifikuese;
- 1.11. shënimi për tërheqje të aplikacionit nëse aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare është publikuar;
- 1.12. varësisht prej rastit, çfarëdo kufizimi i të drejtës, të bërë nga aplikuesi.

2. Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni, paraqiten me anë të kodeve INID, që identifikojnë të dhënat bibliografike në lidhje me markat tregtare, të referuara nga Organizata Botërore për Pronë Intelektuale.

3. Kur aplikimi për regjistrim të markës tregtare tashmë është publikuar, të dhënat përkatëse të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni gjithashtu publikohen në buletin zyrtar të Agjencisë në këto raste:

- 3.1. vendosjes së të dhënave të reja në regjistrin e markave tregtare, të ndërlidhur me ndryshimet në aplikacion;
- 3.2. përmisimeve dhe kufizimeve të aplikacionit;
- 3.3. ndarja e aplikacionit;
- 3.4. korrigjimet e gabimeve.

Neni 13
Përmbajtja e Regjistrit të Markave Tregtare

1. Në përputhje me neni 71, paragrafi 1 të Ligjit për Markat Tregtare, Agjencia mirëmban Regjistrin e Markave Tregtare, i cili gjithashtu përmban të dhëna për aplikacionet për regjistrimin e markave tregtare.
2. Përmbajtja e Regjistrit të Markave Tregtare e ndërlidhur me aplikacionet e markave tregtare rregullohet me nenin 24 të këtij Udhëzimi Administrativ.
3. Aplikacionet për regjistrimin e markave tregtare regjistrohen në Regjistrin e Markave Tregtare, në përputhje me nenin 25 paragrafët 2 dhe 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.

KAPITULLI III
VËREJTJET NGA PALËT E TRETA

Neni 14
Procedura për vërejtjet nga pala e tretë

1. Palët e ineresuara sipas nenit 33 të Ligjit për Marka Tregtare mund të paraqesin vërejte me shkrim në Agjenci, me pretendimin se marka tregtare nuk duhet të regjistrohet për shkak të arsyeve të cekura në nenin 6 të Ligjit për Markat Tregtare. Palët e treta nuk mund të jenë palë në procedurat e regjistrimit para Agjencisë.
2. Vërejtjet nga palët e treta dorëzohen tre muajve nga data e publikimit të një aplikacioni për regjistrimin e një marke tregtare në Buletinin Zyrtar të Agjencisë.
3. Vërejtjet lidhur me regjistrimin e markës tregtare, së bashku me të gjitha dokumentet e bashkëngjitura, i dorëzohen Agjencisë në tri (3) kopje.
4. Agjencia ia komunikon kopjen e vërejtjeve nga paragrafi 1 i këtij neni aplikuesit për regjistrimin e markës tregtare tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i tyre, aplikuesi mund të bëjë përgjigje një (1) muaji pas marrjes së kopjes së vërejtjeve.
5. Sa i përket vërejtjeve nga palët e treta dhe përgjigjen e aplikuesit Agjencia vendos lidhur me aplikacionin e aplikuesit sipas procedurës në përputhje me Ligjin për Markat Tregtare.
6. Vërejtjet e palëve të treta pezullojnë procedurën e regjistrimit për aplikacionet e publikuara.

Neni 15
Përmbajtja e vërejtjeve të palës së tretë

1. Vërejtjet nga palët e treta duhet të përmbajnë:

- 1.1. numrin e aplikacionit për regjistrimin e markës tregtare në lidhje me të cilin janë paraqitur vërejtjet;
 - 1.2. listën e mallrave ose shërbimeve në lidhje me të cilat janë paraqitur vërejtjet;
 - 1.3. emrin dhe adresën e aplikuesit në lidhje me të cilin janë paraqitur vërejtjet;
 - 1.4. të dhëna të qarta lidhur me bazën e vërejtjeve, e të cilat krijojnë bazën ligjore për vërejtjet;
 - 1.5. argumentin dhe arsyetimin ligjor sipas bazave absolute për refuzimin e regjistrimit të markës tregtare, të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit për Markat Tregtare;
 - 1.6. emri, adresa dhe email adresa e palës që paraqet vërejtjet;
 - 1.7. emri, adresa dhe email adresa i përfaqësuesit të palës që paraqet vërejtjet, nëse përfaqësuesi është emëruar;
 - 1.8. autorizimin për përfaqësimin e palës që paraqet vërejtjet, nëse ka të tillë;
 - 1.9. nënshkrimi i palës që paraqet vërejtjet ose të përfaqësuesit të tij.
2. Vërejtjet e palëve të treta mund të përmbajnë detaje të tjera të fakteve, argumenteve dhe provave të paraqitura në mbështetje të pretendimeve të cekura në vërejtje, së bashku me dokumentet përkatëse mbështetëse.

Neni 16

Ri shqyrtimi sipas detyrës zyrtare

Agjencia, sipas detyrës zyrtare mund të rishqyrton procedurën e ekzaminimit lidhur me bazat absolute për refuzim sipas nenit 6 të Ligjit për Marka Tregtare në çfarëdo kohe para ose pas regjistrimit të markës tregtare duke u bazuar në Ligjin Për procedurën e përgjithshme administrative

KAPITULLI IV

KUNDËRSHTIMI

Neni 17

Përmbajtja e kundërshtimit

1. Për secilën aplikacion të publikuar dhe e cila është kundërshtuar në bazë të nenit 34 të ligjit mund të paraqitet vetëm një kundërshtim nga paraqitësi i kundërshtimit. Nëse me një kundërshtim janë kundërshtuar disa aplikacione, Agjencia e fton palën të i ndajë kundërshtimet 2 muajve nga marrja e ftesës për ndarje. Nëse pala nuk përgjigjet, Agjencia e refuzon kundërshtimin me vendim.
2. Kundërshtimi për regjistrimin e markës tregtare përmban:
 - 2.1. numrin e aplikacionit për regjistrimin e markës tregtare në lidhje me të cilin është paraqitur kundërshtimi;
 - 2.2. emrin dhe adresën e aplikuesit në lidhje me të cilin është paraqitur kundërshtimi;
 - 2.3. dukjen e markës tregtare për të cilën është paraqitur kundërshtimi;

- 2.4. listën e mallrave ose shërbimeve për të cilat paraqitet kundërshtimi; nëse lista e mallrave dhe shërbimeve nuk është cekur, konsiderohet se kundërshtimi ka të bëjë me listën e mallrave dhe shërbimeve sipas aplikacionit të kundërshtuar;
- 2.5. indikacion të qartë të dispozitës së nenit 7 të Ligjit për Markat Tregtare që përbën bazën ligjore për kundërshtimin;
- 2.6. të dhënat dhe përshkrimin e markës së mëparshme tregtare ose të të drejtës tjetër mbi të cilën bazohet kundërshtimi, ose:
 - 2.6.1. nëse kundërshtimi bazohet në një markë të mëparshme tregtare në kuptim të nenit 7 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1., 2.2. dhe 2.3. të Ligjit për Markat Tregtare, numrin e aplikacionit ose regjistrimin e markës së mëparshme tregtare, dukjen e markës tregtare, ashtu siç është regjistruar ose për të cilën është paraqitur aplikacioni;
 - 2.6.2. nëse kundërshtimi bazohet në një markë të mirënjohur në kuptim të nenit 7 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4. të Ligjit për Markat Tregtare, cekjen se marka tregtare është e mirënjohur në Republikën e Kosovës, si dhe dukjen e markës tregtare;
 - 2.6.3. nëse kundërshtimi bazohet në një markë të regjistruar tregtare me reputacion, në kuptim të nenit 7 paragrafi 3 nën-paragrafi 3.1 të Ligjit për Markat Tregtare, numrin e aplikacionit dhe regjistrimin e markës së mëparshme tregtare, dukjen e markës tregtare ashtu siç është regjistruar dhe të cekë se marka e mëparshme tregtare ka një reputacion në Republikën e Kosovës;
 - 2.6.4. nëse kundërshtimi bazohet në faktin se pronari i markës tregtare nuk ka dhënë autorizimin për aplikim sipas nenit 7 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2. i Ligjit për Markat Tregtare, dukjen e markës tregtare dhe të cekë nëse për markën e mëparshme tregtare është aplikuar ose nëse është e regjistruar si dhe numrin e aplikacionit ose regjistrimit;
 - 2.6.5. nëse kundërshtimi bazohet në një emërtim të mëparshëm të origjinës ose ndonjë tregues gjeografik paragrafi 3 nën-paragrafi 3.3. i Ligjit për Markat Tregtare, të dhënat dhe paraqitjen e emërtimit të mëhershëm të origjinës apo treguesi gjeografik dhe nëse është i mbrojtur në Republikën e Kosovës, si dhe datën e paraqitjes së aplikacionit apo datën e regjistrimit;
 - 2.6.6. Nëse kundërshtimi bazohet në të dhënat ose në dëshminë e regjistrimit të një biznesi të mëhershëm, ashtu siç përcaktohet në nenin 7 paragrafi 4 nën-paragrafi 4.1. të Ligjit për Markat Tregtare, datën e regjistrimit në regjistrin e bizneseve;
 - 2.6.7. nëse kundërshtimi bazohet në dhënat e drejtë të mëparshme nga neni 7 paragrafi 4 nën-paragrafi 4.2. i Ligjit për Markat Tregtare, informatat mbi llojin ose natyrën e së drejtës, paraqitjen e së drejtës së mëparshme dhe datën nga e cila e drejta e mëparshme ka hyrë në fuqi;
 - 2.6.8. nëse kundërshtimi bazohet mbi keqbesimin, ashtu siç përcaktohet në nenin 7 paragrafi 6, të dhënat të markës së mëparshme tregtare dhe indikacion nëse ajo mbrohet në Republikën e Kosovës apo në ndonjë shtet tjetër;
- 2.7. nëse është aplikuar ose regjistruar një markë e mëparshme tregtare, datën e paraqitjes së saj dhe, nëse e ka të pranuar datën e regjistrimit dhe datën e përparësisë të mëparshëm të markës tregtare;
- 2.8. nëse kundërshtimi bazohet në një markë të mëparshme tregtare për të cilat është regjistruar apo për të cilat është aplikuar marka e mëparshme tregtare për mallrat dhe shërbimet për të cilat ka bazë për kundërshtim;
- 2.9. mallrat dhe shërbimet për të cilat marka e mëparshme tregtare, dëshmon se është bërë e mirënjohur në Republikën e Kosovës para datës së përparësisë së pranuar të aplikacionit kundër së cilës është paraqitur kundërshtimi;

- 2.10. mallrat dhe shërbimet për të cilat marka e mëparshme tregtare, dëshmon se ka fituar reputacion në Republikën e Kosovës para datës së përparësisë së pranuar të aplikacionit kundër së cilës është paraqitur kundërshtimi;
 - 2.11. nëse një markë e mëparshme tregtare ka disa pronar ose nëse një e drejtë e mëparshme i takon disa pronarve, mund të parashtrohet një kundërshtim nga të gjithë pronarët apo personat e autorizuar së bashku, ose cilido pronar individualisht apo së bashku me një pronar tjetër apo së bashku me një person të autorizuar tjetër;
 - 2.12. emri, adresa dhe emaili i palës e cila parashtron kundërshtimin;
 - 2.13. emri, adresa dhe emaili i përfaqësuesit të palës e cila parashtron kundërshtimin, nëse kundërshtimi është paraqitur përmes përfaqësuesit;
 - 2.14. kur kundërshtimi paraqitet nga një i licencuar ose një person i cili është i autorizuar për të ushtruar një të drejtë të mëparshme në përputhje me legjislacionin përkatës, të dhënat përkatëse mbi autorizimin ose të drejtën për të paraqitur kundërshtimin, të dhënat e licencës, adresën dhe email adresën;
 - 2.15. kur emri ose adresa e palës që ka paraqitur kundërshtimin nuk janë identike me emrin ose adresën e pronarit të markës së mëparshme mbi të cilën bazohet kundërshtimi, pala obligohet të deshmojë historikun e ndryshimeve të emrit të pronarit apo adreses;
 - 2.16. nënshkrimi i paraqitësit, ose përfaqësuesit të kundërshtimit;
 - 2.17. dëshminë e pagesës së taksës përkatëse.
3. Kundërshtimi mund të përmbajë detaje të tjera të fakteve, argumenteve dhe provave që paraqiten në mbështetje të pretendimeve të cekura në kundërshtim, së bashku me dokumentet përkatëse mbështetëse.
 4. Kundërshtimi i markës tregtare së bashku me të gjitha dokumentet e bashkangjitura i dorëzohen Agjencisë në dy kopje.
 5. Nëse kundërshtimi bazohet në disa marka tregtare të mëparshme ose të drejta të tjera të mëparshme, paragrafi 2 i këtij neni zbatohet për secilën nga këto marka të mëparshme ose të drejta të tjera të mëparshme.
 6. Paraqitësi i kundërshtimit në çdo kohë mund heq dorë nga kundërshtimi. API lëshon vendim për heqjen dorë apo tërheqje të kundërshtimit

Neni 18

Shtojcat e kundërshtimit

1. Kundërshtimit i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:

1.1. një kopje e certifikatës ose një dokument i barazvlefshëm lidhur me aplikacionin për regjistrimin e një marke të mëparshme nga një zyrë kompetente ose një kopje të certifikatës apo vërtetim përkatës të regjistrimit të markës tregtare ose, certifikatën e vazhdimit të regjistrimit të një marke të mëparshme, nëse kundërshtimi bazohet në një markë të mëparshme tregtare sipas nenit 7 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1., 2.2., dhe 2.3. të Ligjit për Markat Tregtare.

1.2. dëshmi se një markë tregtare e mëparshme është e mirënjohur në Republikën e Kosovës për mallrat dhe shërbimet për të cilat është paraqitur kërkesa për regjistrimin e një marke tregtare, nëse

kundërshtimi bazohet në markën e mëparshme të mirënjohur në Republikën e Kosovës sipas nenit 7 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4. të Ligjit për Markat Tregtare;

1.3. dëshmi se një markë e mëparshme tregtare ka reputacion në Republikën e Kosovës dhe dëshmi ose argumente se përdorimi i markës tregtare në aplikacionin e kontestuar, padrejshisht shfrytëzon karakterin dallues apo reputacionin e markës së mëparshme nëse kundërshtimi bazohet në një markë të mëparshme nga neni 7 paragrafi 3 nën-paragrafi 3.1. i Ligjit për Markat Tregtare;

1.4. dëshmi se paraqitësi i kundërshtimit është pronar i markës së mëparshme tregtare dhe dëshmi e raportit të tij me përfaqësues, nëse kundërshtimi bazohet në faktin se pronari i markës tregtare nuk ka dhënë autorizimin e tij nga neni 7 paragrafi 3. Nën-paragrafi 3.2. i Ligjit për Markat Tregtare;

1.5. një kopje të ekstraktit ose dokument të barazvlefshëm që kompania është e regjistruar në regjistrin e biznesit dhe dëshmi se mallrat ose shërbimet, që janë objekt i veprimtarisë së asaj kompanie, janë duke u përdorur në tregti, nëse kundërshtimi bazohet në një kompani të mëparshme nga neni 7 paragrafi 4 nën-paragrafi 4.1. i Ligjit për Markat Tregtare;

1.6. dëshmi për pronarin e së drejtës, datën e fitimit të së drejtës, ekzistencën e saj, fushëveprimin e mbrojtjes, nëse kundërshtimi bazohet në një nga të drejtat e mëparshme nga neni 7 paragrafi 4 nën-paragrafi 4.2. i Ligjit për Markat Tregtare;

1.7. dëshmi e përfutimit, ekzistencës dhe fushëveprimit të mbrojtjes, nëse kundërshtimi bazohet në një emërtim të origjinës ose një tregues gjeografik nga neni 7 paragrafi 3 nën-paragrafi 3.3. i Ligjit për Markat Tregtare;

1.8. Një përmbledhje e faktorëve dhe parashtrimi i provave prima facie se aplikimi është paraqitur me keqbesim.

1.9. dëshmi për pagesën e taksës për paraqitjen e kundërshtimit;

1.10. autorizimin e përfaqësuesit nëse ka ose një dëshmi se përfaqësimi bazohet në një autorizim të përgjithshëm i regjistruar në regjistrin e autorizimeve të përgjithshme që mban Agjencia.

2. Nëse dëshmitë për aplikimin ose regjistrimin e të drejtave të mëparshme nga paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1, 1.4. deri në 1.8. të këtij neni janë në dispozicion online duke shqyrtuar bazat e të dhënave zyrtare, paraqitësi i kundërshtimit mund të paraqesë dëshmi duke iu referuar burimit të tillë.

3. Për të vlerësuar nëse një markë tregtare është e mirënjohur në kuptim të nenit 7 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4. të Ligjit për Markat Tregtare dhe paragrafit 1.2 të këtij neni, Agjencia vepron sipas rekomandimeve për mbrojtjen e markave të mirënjohura, të miratuara nga Asambleja e Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Asambleja e Përgjithshme e WIPO-së në 1999, dhe Rekomandimeve të Përbashkëta të WIPO-së në lidhje me Dispozitat për Mbrojtjen e Markave dhe të Drejtave të tjera të Pronësisë Industriale në Shenja, në Internet, miratuar nga Asambleja e Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Asamblesë së Përgjithshme të WIPO në vitin 2001.

4. Paragrafet në vijim konsiderohen si listë jo-shteruese e faktorëve kur vlerësohet aplikimi me keqbesim, në kuptim të nenit 7 paragrafi 6 i Ligjit për Markat Tregtare në rastet kur:

4.1. aplikuesi ose bartësi është identifikuar si paraqitës me keqbesim nga Agjencia;

4.2. aplikuesi ose bartësi ka pasur një marrëdhënie paraprake me pronarin e ligjshëm, por duke mos u kufizuar vetëm në, si bartës i franshizës ose distributor i mallrave/shërbimeve të pronarit të ligjshëm;

4.3. aplikuesi ose bartësi ka tentuar të shesë, për çmim më të madh se shpenzimet e procedurës, një aplikacion ose regjistrim pronarit të ligjshëm të markës;

4.4. marka është identike ose shumë e ngjashme me një markë që ka një nivel të caktuar të reputacionit në juridiksionin përkatës. Nuk është e nevojshme që pronari i ligjshëm të ketë regjistruar, parashtruar ose përdorur markën në juridiksionin ku është parashtruar aplikacioni me keqbesim, me kusht që pronari i ligjshëm të mund të dëshmojë reputacionin e tij në atë juridiksion.

4.5. bartësi i ligjshëm i markës tregtare posedon të drejta të ndërlidhura të pronësisë intelektuale për atë markë në juridiksionin përkatës, përfshirë por pa u kufizuar vetëm në dizajnin, emrat tregtarë, të drejtat e autorit dhe/ose emrat personalë.

4.6. ka prova të tjera që tregojnë tendenca të sjelljes së ngjashme, siç janë, por pa u kufizuar vetëm në, grumbullimin/trafikimin e emrave të domeneve, kopjimin e veshjeve tregtare, përdorimin ose regjistrimin e emrit tregtar.

4.7. aplikacioni ose regjistrimi përfshin, pa dallim, të gjitha ose shumicën e klasave të Marrëveshjes së Nices, gjë që është padyshim në kundërshtim me qëllimin e aplikuesit ose të bartësit për përdorim dhe/ose interesin me mirëbesim për markën tregtare.

4.8. aplikuesi ose bartësi ka bërë regjistrime të shumta të markave të palëve të treta ose të llojeve të tjera të pronësisë intelektuale që u përkasin disa palëve të treta.

4.9. aplikuesi ose bartësi nuk paraqet dëshmi të ndonjë veprimtarie të mirëfilltë afariste ose qëllim të mirëfilltë për të përdorur markën.

5. Faktorët e mësipërm të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, të cilët janë udhëzime për të ndihmuar API-në për të përcaktuar nëse marka tregtare është paraqitur me keqbesim, nuk janë parakushte për të arritur në një përfundim të tillë. Arritja e përfundimit të tillë, në secilin rast, varet nga rrethanat e veçanta të atij rasti. Në disa raste, të gjithë faktorët mund të jenë relevant. Në raste të tjera, vetëm disa faktorë mund të jenë relevant. Në raste të tjera, asnjëri nga faktorët mund të mos jenë relevant, dhe vendimi mund të bazohet në faktorë shtesë që nuk janë renditur në paragrafin 4 të këtij neni. Faktorë të tillë shtesë mund të jenë të relevant, të vetëm, ose në kombinim me një ose më shumë nga faktorët e renditur në paragrafin 4 të këtij neni .

Neni 19

Kundërshtime të shumëfishta

1. Në rastet kur janë paraqitur dy ose më shumë kundërshtime kundër të njëjtit aplikacion për regjistrimin e markës tregtare, Agjencia mund t'i shqyrtojë këto kundërshtime në një procedurë të përbashkët ose të veçantë.

2. Pas shqyrtimit të kundërshtimeve të shumëfishta në një procedurë, Agjencia mund të nxjerrë një vendim të vetëm për të gjitha kundërshtimet ose vendime të veçanta për secilin kundërshtim. Të gjitha vendimet e Agjencisë iu dorëzohen të gjitha palëve në procedurë.

3. Kur shqyrton kundërshtimet e shumëfishta në një procedurë, Agjencia mund të vendosë të pranojë pretendimet nga një kundërshtim, por të refuzojë pretendimet e një kundërshtimi tjetër në të njëjtën procedurë.

4. Kur pretendimet e kundërshtimeve të shumëfishta janë të njëjta, Agjencia nxjerr një vendim të vetëm.

Neni 20

Përdorimi i markës tregtare në procedurën e kundërshtimit

1. Nëse aplikuesi për regjistrimin e një marke që është objekt i kundërshtimit e kërkon shprehimisht nga pronari i një marke të mëparshme që ka paraqitur kundërshtimin ndaj regjistrimit duhet të paraqesë dëshminë se gjatë periudhës pesëvjeçare para datës së publikimit të aplikacionit të kundërshtuar, marka e mëparshme tregtare e cila është bazë për kundërshtimin, ka qenë në përdorim të mirëfilltë ashtu siç parashihet me nenin 16 të Ligjit për Markat Tregtare, për mallrat ose shërbimet për të cilat është regjistruar dhe të cilat përmenden si justifikim për kundërshtimin e tij, ose që ka arsye të justifikuara për mospërdorim, me kusht që, në këtë datë, marka e mëparshme tregtare të ketë qenë e regjistruar për jo më pak se pesë vjet.

2. Aplikuesi parashtron kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni, së bashku me vërejtjet e tij për kundërshtimin nga neni 35 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit për Markat Tregtare.

3. Pas pranimit të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencia fillimisht shqyrton nëse marka e mëparshme tregtare, e cila është bazë për kundërshtimin, është regjistruar për të paktën pesë vjet. Nëse marka tregtare nuk është e regjistruar për të paktën pesë vjet, Agjencia me vendim refuzon kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni, pa e ftuar kundërshtuesin që të paraqesë vërejtjet e veta për kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni. Agjencia vazhdon procedurën e shqyrtimit për kundërshtimin nga neni 35 i ligjit për Markat Tregtare.

4. Nëse Agjencia konsideron se marka e mëparshme tregtare, e cila është bazë për kundërshtimin, është regjistruar për të paktën pesë vjet, ajo fton kundërshtuesin që të paraqesë vërejtjet e veta për kërkesën nga paragrafi 1 të këtij neni në një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e marrjes së ftesës.

5. Nëse pronari i një marke të mëparshme tregtare nuk paraqet vërejtjet e tij në lidhje me kërkesën për të dëshmuar përdorimin e markës së mëparshme tregtare ose nëse ai nuk arrin të dëshmojë përdorimin ose të jep arsye të justifikuara për mospërdorimin e markës së mëparshme tregtare, kundërshtimi refuzohet me vendim dhe procedura e aplikimit për regjistrimin e markës tregtare vazhdon pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.

6. Nëse pronari i një marke të mëparshme tregtare paraqet vërejtjet e tij në lidhje me kërkesën për të dëshmuar përdorimin e markës së mëparshme tregtare në afatin e përcaktuar kohor, Agjencia ia përcjellë një kopje të vërejtjeve të tilla aplikuesit për regjistrimin e markës tregtare dhe e fton atë të paraqesë vërejtjet e tij një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të ftesës.

7. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, Agjencia vendos për arsyetimin e kundërshtimit në bazë të fakteve dhe dëshmive në dispozicion nga dokumentet dhe vërejtjet e dorëzuara më parë.

8. Nëse marka e mëparshme tregtare është përdorur në lidhje vetëm me një pjesë të mallrave ose shërbimeve për të cilat është regjistruar ajo, për qëllime të shqyrtimit të arsytimit të kundërshtimit, konsiderohet të jetë regjistruar në lidhje vetëm me atë pjesë të mallrave ose shërbimeve.

9. Dëshmia e përdorimit duhet të përmbajë të dhëna në lidhje me vendin, kohën, shtrirjen dhe natyrën e përdorimit të markës së kundërshtuar për mallrat ose shërbimet në lidhje me të cilat është regjistruar dhe mbi të cilat bazohet kundërshtimi.

10. Dëshmitë përfshijnë paraqitjen e dokumenteve përkatëse dhe artikujve siç janë paketimet, etiketat, çmimoret, katalogët, faturat, fotografitë, reklamat dhe gjësende të tjera të përshtatshme që mund të shërbejnë si dëshmi e përdorimit të markës së mëparshme. Gjithashtu, si dëshmi e përdorimit, mund të përdoren rezultatet e ndonjë hulumtimi, me kusht që hulumtimi t'i referohet periudhës pesëvjeçare para datës së publikimit të aplikacionit të markës së kundërshtuar.

11. Pronari i markes së mëparshme tregtare dorëzon dëshmitë nga paragrafi 9 dhe 10 i këtij neni së bashku me vërejtjet nga paragrafi 4 i këtij neni.

12. Vërejtjet lidhur me kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni, së bashku me dëshmitë nga paragrafi 9 dhe 10 i këtij neni, dorëzohen në 2 kopje.

13. Dispozitat e përmendura në këtë nen aplikohen në përputhje me rrethanat edhe për procedurën e paraqitjes së dëshmisë së përdorimit të përmendur në procedurat e revokimit, pavleshmërisë dhe shfuqizimit të markës tregtare

Neni 21

Procedura për shqyrtimin e kundërshtimit

1. Tre (3) muaj nga data e publikimit të aplikacionit për regjistrimin e markës tregtare, subjektet nga neni 34 paragrafi 1 i Ligjit për markat tregtare mund të paraqesin kundërshtim kundër regjistrimit të aplikacionit për markës tregtare.

2. Kundërshtuesi arsyeton dhe saktëson qartë arsyet të cilat janë bazë për kundërshtimin, duke ndjekur bazat relative nga neni 7 i Ligjit për Markat Tregtare, në përputhje me nenet 16 deri 20 të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Kundërshtimit i bashkëngjitet dëshmia e pagesës së taksës përkatëse. Nëse pala nuk ka bërë pagesën e taksës përkatëse Agjencia e fton palën të bëjë pagesën 2 muajve. Nëse pala nuk e paguan taksën, Agjencia refuzon kundërshtimin.

4. Kundërshtimi i paraqitur shqyrtohet nga Agjencia lidhur me pranueshmërinë formale, duke kontrolluar nëse kundërshtimi është paraqitur brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni. dhe nëse është paguar taksa përkatëse nga paragrafi 3 i këtij neni. Nëse Agjencia konstaton se këto kërkesa nuk janë përmbushur, e refuzon kundërshtimin me vendim.

5. Nëse Agjencia konstaton se janë përmbushur kërkesat nga paragrafi 4 i këtij neni, ia dërgon aplikuesit kopjen e kundërshtimit së bashku me të gjitha bashkëngjitjet e dorëzuara në Agjenci dhe

e fton që t'i paraqesë vërejtjet e tij gjashtëdhjetë (60) ditëve nga marrja e ftesës. Ky afat kohor nuk mund të zgjatet.

6. Në vërejtjet e tij ndaj kundërshtimit, aplikuesi mund të paraqesë detaje të fakteve, argumenteve dhe provave në mbështetje të pretendimeve të tij kundër kundërshtimit, së bashku me dokumentet përkatëse mbështetëse, ashtu siç parashihet në nenin 35 paragrafi 3 të Ligjit për Markat Tregtare. Së bashku me kundërshtimet, aplikuesi mund të paraqesë kërkesë për dëshminë e përdorimit në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Markat Tregtare dhe Nenin 19 të këtij Udhëzimi Administrativ.

7. Agjencia shqyrton kundërshtimin në procedurën e rregulluar me nenet 35 dhe 37 të Ligjit për Markat Tregtare, duke zbatuar nenin 7 të Ligjit për Markat Tregtare dhe nenet 16 deri 20 të këtij Udhëzimi Administrativ dhe duke marrë parasysh vërejtjet e aplikuesit për kundërshtimin dhe kërkesën për dëshminë e përdorimit.

8. Nëse aplikuesi nuk paraqet vërejtjet ndaj kundërshtimit brenda afatit të caktuar, aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare refuzohet dhe Agjencia nxjerr vendim për pranimin e kundërshtimit dhe e refuzon aplikacionin për regjistrimin.

9. Nëse, pas procedurës së kundërshtimit, aplikuesi tërheq aplikimin e publikuar për regjistrimin e markës tregtare, Agjencia nxjerr vendim për pranimin e kundërshtimit dhe e bënë tërheqjen e aplikacionit.

10. Nëse pas procedurës së kundërshtimit, aplikuesi tërheq aplikimin e publikuar për regjistrimin e një marke tregtare vetëm për disa mallra dhe shërbime, Agjencia nxjerr vendimin për pranimin e kundërshtimit në lidhje me ato mallra dhe shërbime dhe vazhdon procedurën e ekzaminimit sipas paragrafëve 7, 11 deri 13 të këtij neni për mallrat dhe shërbimet e mbetura.

11. Në vendim, Agjencia paraqet saktësisht mallrat dhe shërbimet e aplikacionit të kundërshtuar, për të cilin pranohet kundërshtimi dhe listën e mallrave dhe shërbimeve të aplikacionit të kundërshtuar për të cilat vazhdon procedura e regjistrimit. Agjencia refuzon aplikacionin për mallrat dhe shërbimet për të cilat pranohet kundërshtimi për shkak të tërheqjes së pjesshme të aplikuesit.

12. Nëse nga shqyrtimi i kundërshtimit rezulton se kundërshtimi është i paarsyetuar, Agjencia e refuzon kundërshtimin. Vendimi për refuzimin e kundërshtimit i dërgohet si kundërshtuesit ashtu edhe aplikuesit dhe, pasi të merr formë të prerë, vazhdon procedura për regjistrimin e markës tregtare.

13. Nëse nga shqyrtimi i kundërshtimit rezulton se kundërshtimi është i bazuar vetëm për një pjesë të mallrave ose shërbimeve të përfshira në aplikacion, procedura e regjistrimit të markës tregtare vazhdon pasi një vendim i tillë të ketë marrë formë të prerë, për pjesën e mallrave ose shërbimeve për të cilat vërtetohet se mund të jepet regjistrimi i kërkuar ose të cilat nuk janë objekt i kundërshtimit. Në vendimin për kundërshtimin, Agjencia liston shprehimisht mallrat dhe shërbimet për të cilat refuzohet marka tregtare dhe listën e mallrave dhe shërbimeve për të cilat vazhdon procedura e regjistrimit.

14. Nëse nga shqyrtimi i kundërshtimit rezulton se kundërshtimi është i bazuar për të gjitha mallrat ose shërbimet për të cilat është bërë aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare, kundërshtimi pranohet dhe aplikacioni për regjistrim refuzohet.

15. Vendimet nga paragrafët 11 deri në 13 të këtij neni arsyetohen lidhur me secilën bazë për kundërshtim nga neni 7 i Ligjit për markat tregtare. Agjencia ia dërgon këtë vendim si kundërshtuesit ashtu edhe aplikuesit.

16. Nëse në datën e publikimit të aplikimit në Buletinin Zyrtar, marka e mëparshme mbi të cilën bazohet kundërshtimi është në procedurë të revokimit ose shfuqizimit, Agjencia pezullon procedurën e kundërshtimit deri në marrje të vendimit përfundimtar nga procedura e revokimit ose e shfuqizimit.

17. Agjencia nuk shqyrton asnjë bazë nga neni 7 i Ligjit për Markën Tregtare ex officio, pa pasur kundërshtim, edhe nëse është e qartë se aplikacioni nuk duhet të regjistrohet për ndonjërin prej arsyeve të përcaktuara në nenin 7 i Ligjit për Markën Tregtare. Barra e provës për ekzistimin e bazave relative nga neni 7 i Ligjit për markat tregtare është ekskluzivisht mbi kundërshtuesin dhe Agjencia nuk mbledh asnjë provë apo dëshmi me iniciativë të vet.

18. Agjencia mund të pezullojë procedurën e regjistrimit apo shqyrtimin e kundërshtimit nëse konstaton se një çështje e nderlidhur paraprake është duke u shqyrtuar në institucionet gjyqësore ose ndonjë organ tjetër, rezultati i së cilës mund të ndikojë në marrjen e vendimit përfundimtar nga API.

19. Nëse palët nuk kanë parashtruar Ankesë drejtuar Komisionit në afat prej 30 ditëve, ndaj vendimit të Agjencisë, Agjencia vazhdon procedurën sipas dispozitave ligjore.

20. Pala nëse paraqet padi ndaj vendimit të komisionit të ankesave në gjykatën kompetente duhet të informoj API brenda 30 ditëve, nëse API nuk njoftohet për paraqitjen e padisë brenda afatit, atëherë API konsideron se vendimi i komisionit ka marrë formë të prirë.

21. Parashtrimi i padisë pezullon ekzekutimin e vendimit të API deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente.

Neni 22

Procedura e ndërmjetësimit

1. Me kërkesë të përbashkët të palëve, Agjencia pezullon procedurat e kundërshtimit për së paku dy (2) muaj në mënyrë që të jepet mundësia e zgjidhjes miqësore ndërmjet kundërshtuesit dhe aplikuesit. Agjencia lëshon njoftim për pezullimin e procedurave, duke saktësuar periudhën e pezullimit dhe njofton palët.

2. Me kërkesë të përbashkët të palëve, Agjencia mund të zgjat periudhën e pezullimit. Në atë rast, Agjencia lëshon njoftim të ri për pezullimin e procedurave, ku saktësohet periudhën e re të pezullimit dhe njofton palët.

3. Pas skadimit të afatit në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, nëse palët nuk e njoftojnë Agjencinë për ndonjë marrëveshje eventuale, Agjencia vazhdon procedurën e kundërshtimit.
4. Në rastin e arritjes së marrëveshjes palët e njoftojnë Agjencinë përmes një dëshme të nënshkruar nga të dyja palët, se kanë arritur marrëveshje.
5. Nëse API e sheh të nevojshme ajo mund të organizoj mbajtjen e seancave diskutimi për procedurat e kundërshtimit.
6. Ky nen aplikohet edhe për procedurat për revokimin, pavleshmerisë dhe shfuqizimin e markave tregtare.
7. API nëse e vlerëson të nevojshme mund të ftoj takime konsultative për sqarime dhe dokumentet shtese, palët në procedurat para API.

KAPITULLI V

KUFIZIMI I LISTËS SË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE DHE NDARJA E APLIKIMIT APO REGJISTRIMIT

Neni 23

Kufizimi i listës së mallrave dhe shërbimeve

1. Kërkesa për kufizimin e listës së mallrave ose shërbimeve në aplikimin për regjistrimin e markës tregtare sipas nenit 38 paragrafi 1 të Ligjit për markat tregtare, përmban:
 - 1.1. numrin e aplikimit për regjistrimin e markës tregtare;
 - 1.2. emrin dhe adresën e aplikuesit;
 - 1.3. emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse është caktuar;
 - 1.4. listën e kufizuar të mallrave dhe shërbimeve;
 - 1.5. nënshkrimin e aplikuesit ose përfaqësuesit të tij;
 - 1.6. dëshminë për pagesën e taksës përkatëse.
2. Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet përshtatshëmrisht edhe për kufizimin e mallrave ose shërbimeve në regjistrim.
3. Pas pranimit të kërkesës për kufizim të listës së mallrave dhe shërbimeve në aplikim ose në regjistrimin e një marke tregtare, Agjencia nxjerr një vendim që tregon saktësisht se cilat mallra dhe shërbime mbeten në listë. Në arsyetimin e këtij vendimi, Agjencia cek se për cilat mallra dhe shërbime është paraqitur kërkesa për kufizim nga aplikuesi ose pronari i markës tregtare dhe se cilat mallra dhe shërbime mbeten në Regjistrin e Markave Tregtare.
4. Agjencia i dërgon aplikuesit ose pronarit të markës tregtare vendimin sipas paragrafit 3 të këtij neni, publikon në Buletinin Zyrtar të Agjencisë listën e kufizuar dhe fshin nga Regjistri i Markave Tregtare mallrat dhe shërbimet për të cilat është paraqitur kërkesa për kufizim dhe për të cilin është lëshuar vendimi përkatës.

Neni 24

Ndarja e aplikacionit ose regjistrimit

1. Kërkesa për ndarjen e aplikimit ose regjistrimit të markës tregtare sipas nenit 44 të Ligjit për Markat Tregtare, përmban:

- 1.1. numrin e aplikacionit fillestar ose regjistrimit fillestar të markës tregtare;
- 1.2. emrin dhe adresën e aplikuesit ose pronarit të markës tregtare;
- 1.3. emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ka të tillë;
- 1.4. listën e mallrave ose shërbimeve nga aplikimi ose regjistrimi për të cilën kërkohet ndarja, nëse kërkohen aplikime ose regjistrime që janë objekt i ndarjes, listën e mallrave dhe shërbimeve për secilin aplikacion apo regjistrim ndarës.
- 1.5. listën e mallrave ose shërbimeve që mbeten në aplikimin ose regjistrimin e parë;
- 1.6. nënshkrimin e aplikuesit ose pronarit të markës tregtare apo përfaqësuesit, nëse ka të tillë;
- 1.7. dëshminë për pagesën e taksës përkatëse.

2. Për çdo aplikim të ndarë ose regjistrim të ndarë të një marke tregtare paraqitet një kërkesë e veçantë.

3. Agjencia krijon dosje të re për çdo aplikim ose regjistrim të ndarë që përmban një kopje të plotë të aplikimit fillestar ose regjistrimit fillestar, duke përfshirë kërkesën për ndarje dhe korrespondencën përkatëse. Çdo regjistrimi të ndarë i caktohet një numër i ri i dosjes.

4. Mallrat ose shërbimet në aplikimin ose regjistrimin e ndarë nuk do të përkojnë me mallrat ose shërbimet që mbeten në aplikimin ose regjistrimin fillestar ose ato që përfshihen në aplikime ose regjistrime të tjera të ndara.

5. Kur Agjencia konstaton se nuk janë përmbushur kërkesat në paragrafin 1 të këtij neni, apo se lista e mallrave dhe shërbimeve që do të formojnë aplikimin ose regjistrimin e ndarë përputhet pjesërisht ose plotësisht me mallrat dhe shërbimet që do të mbeten në aplikimin ose regjistrimin fillestar, ajo fton aplikuesin që t'i korrigjojë mangësitë gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i kërkesës së tillë.

6. Nëse mangësitë e konstatuara nga Agjencia nuk plotësohen në përputhje me ftesën ose nuk plotësohen afatit të përcaktuar, Agjencia refuzon kërkesën për ndarjen e aplikimit apo regjistrimit.

7. Të gjitha kërkesat dhe procedurat e në lidhje me aplikimin ose regjistrimin e parë të bëra përpara datës në të cilën Agjencia pranon kërkesën për ndarjen e aplikimit ose regjistrimit, konsiderohen të iniciuara edhe për sa i përket aplikimit ose regjistrimit të ndarë.

8. Përfaqësuesi i caktuar për aplikimin fillestar ose regjistrimin fillestar, konsiderohet të jetë edhe përfaqësuesi për aplikimet e ndara ose regjistrimet e ndara.

KAPITULLI VI
REGJISTRI I MARKAVE TREGTARE, PUBLIKIMI I MARKAVE TREGTARE,
CERTIFIKATA E MARKËS TREGTARE

Neni 25
Përmbajtja e Regjistrimit të Markave Tregtare

1. Regjistri i Markës Tregtare përmbanë:

- 1.1. numrin e aplikacionit dhe regjistrimit të markës;
- 1.2. datën e paraqitjes të aplikacionit;
- 1.3. datën e publikimit të aplikacionit në Buletinin Zyrtarë të Agjencisë;
- 1.4. emrin dhe adresën e aplikuesit apo pronarit të markës tregtare;
- 1.5. emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ka të tillë;
- 1.6. dukjen e markës;
- 1.7. listën e mallrave dhe shërbimeve për të cilat është aplikuar apo regjistruar marka;
- 1.8. datën dhe numrin e aplikacionit të parë si dhe Shtetin e paraqitjes të tij nëse është kërkuar e drejta e përparësisë;
- 1.9. datën e prioritetit të ekspozimit nëse është dhënë drejta e përparësisë;
- 1.10. shënimin e qartë se a është “markë verbale”, “markë figurative”, “markë tredimensionale”, “markë e përbërë nga një ngjyrë ose kombinim të ngjyrave”, apo lloj tjetër i markës”,
- 1.11. kur aplikohet për regjistrim me ngjyrë, shënimin “me ngjyrë” dhe të dhënat për ngjyrat të cilat e përbëjnë markën dhe mundësisht referencën në një kod ngjyre të pranuar ndërkombëtarisht;
- 1.12. shënimin e qartë se a është aplikacioni i paraqitur për markë kolektive ose certifikuese;
- 1.13. data e regjistrimit të markës tregtare dhe numrin e regjistrimit;
- 1.14. datën e publikimit të regjistrimit të markës tregtare në buletin zyrtar të Agjencisë;
- 1.15. datën skadimit të regjistrimit të markës tregtare.

2. Regjistri i Markës Tregtare duhet gjithashtu të përmban edhe këto të dhëna, të cilat duhet të shoqërohen me datën e regjistrimit, si:

- 2.1. të dhënat për ndryshimet lidhur me markën tregtare, ndryshimet e emrit dhe adresës së paraqitësit të aplikacionit, pronarit ose përfaqësuesit të tij, ndryshimit të përfaqësuesit, bartjes të plotë ose të pjesshëm të të drejtave, dhënies ose bartjes të licencës si dhe anulimin e saj, krijimit ose transferimit të së drejtës së pengut si dhe anulimin e saj, taksa e përmbartimit si dhe anulimin e saj, falimentimi ose procedimet e ngjashme si dhe anulimin e saj;
- 2.2. të dhënat lidhur me përmirësimet në aplikacion ose regjistrim;
- 2.3. përmirësimet e kontratës e cila përcakton përdorimin e markës kolektive ose certifikuese;
- 2.4. shënim të heqjes dorë të markës tregtare dhe në rast se heqja dorë ka të bëjë me disa nga mallrat për të cilat është regjistruar marka tregtare, listën e mbetur të mallrave dhe shërbimeve;
- 2.5. ndarja e regjistrimit si dhe listën e mallrave dhe shërbimeve të regjistrimit origjinal ashtu siç është përmirësuar;
- 2.6. vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare dhe çfarëdo kufizimi;
- 2.7. datën e paraqitjes së kërkesës për revokim, kundërshtim ose kërkesës për deklarim të shfuqizimit;

2.8. datën dhe përmbajtjen e vendimit përfundimtar për revokim, kundërshtim ose shfuqizimi i markës tregtare.

3. Regjistri i Markës Tregtare përveç formës fizike mund të mbahet dhe në formë të bazës elektronike të të dhënave.

Neni 26 **Publikimi i regjistrimit**

1. Buletini Zyrtar i Agjencisë përmban këto të dhëna:

- 1.1. numrin e regjistrimit të markës tregtare;
- 1.2. datën e regjistrimit të markës tregtare;
- 1.3. datën e paraqitjes të aplikacionit;
- 1.4. emrin dhe adresën e pronarit të markës tregtare;
- 1.5. emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ka të tillë
- 1.6. dukja e markës tregtare;
- 1.7. listën e mallrave dhe shërbimeve për të cilat është regjistruar marka tregtare;
- 1.8. datën dhe numrin e aplikacionit të parë si dhe shtetin e paraqitjes së tij nëse është dhënë drejta e përparësisë;
- 1.9. datën e përparësisë të ekspozimit nëse është dhënë drejta e përparësisë;
- 1.10. të dhënat se a është fjala për: “markë verbale”, “markë figurative”, “markë tredimensionale”, markë e përbërë nga një ngjyrë ose kombinim të ngjyrave” apo një “lloj tjetër i markës”,
- 1.11. kur aplikohet për regjistrim me ngjyrë, dhe të dhënat për ngjyrat të cilat e përbëjnë markën dhe referencën në një kod ngjyre të pranuar ndërkombëtarisht,
- 1.12. të dhënat se a është fjala për markë kolektive ose certifikuese,
- 1.13. datën e skadimit të regjistrimit të markës tregtare.
- 1.14. ndryshimet në Regjistrin e markave tregtare për ndryshimet në lidhje me markën tregtare;
- 1.15. korrigjimet dhe kufizimet të regjistrimit të markës tregtare;
- 1.16. ndarjes së regjistrimit;
- 1.17. vazhdimine regjistrimit të markës tregtare;
- 1.18. korrigjimit të gabimeve teknike.

2. Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni paraqiten me kode INID.

Neni 27 **Kërkesa për lëshimin e certifikatës së markës tregtare**

1. Kërkesa për lëshimin e certifikatës së markës tregtare përmban:

- 1.1. numrin e regjistrimit;
- 1.2. emrin dhe adresën e pronarit të markës tregtare;
- 1.3. emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse është caktuar;
- 1.4. pagesën e taksës përkatëse.

2. Për dy ose më shumë regjistrime të të njëjtit pronar, mund të bëhet vetëm një kërkesë për lëshimin e certifikatës së markës tregtare.

3. Pronari i markës tregtare mund të kërkojë ri-lëshimin e certifikatës pas pagesës së taskës përkatëse.

Neni 28

Përmbajtja e certifikatës së markës tregtare

1. Certifikata e markës tregtare përmbanë këto të dhëna:

- 1.1. numrin e regjistrimit të markës tregtare;
- 1.2. datën e regjistrimit të markës tregtare;
- 1.3. datën e paraqitjes të aplikacionit;
- 1.4. emrin dhe adresën e pronarit të markës tregtare;
- 1.5. emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ka të tillë;
- 1.6. dukja e markës;
- 1.7. listën e mallrave dhe shërbimeve për të cilat është regjistruar marka;
- 1.8. datën dhe numrin e aplikacionit të parë si dhe shtetin e parashtrimit të tij nëse është dhënë e drejta e përparësisë;
- 1.9. datën e përparësisë të ekspozimit;
- 1.10. shënimin e qartë se a është fjala për “markë verbale”, “markë figurative”, “markë tredimensionale apo markë e përbërë nga një ngjyrë ose kombinim të ngjyrave”, apo një “lloj tjetër i markës”,
- 1.11. kur aplikohet për regjistrim me ngjyrë, të dhënat për ngjyrat të cilat e përbëjnë markën dhe referencën në një kod ngjyre të pranuar ndërkombëtarisht,
- 1.12. cekjen e qartë se a është fjala për markë kolektive apo certifikuese;
- 1.13. datën e publikimit të regjistrimit të markës tregtare në Buletinin Zyrtar të Agjencisë;
- 1.14. datën e skadimit të regjistrimit të markës tregtare;
- 1.15. datën e publikimit të regjistrimit të markës tregtare në Buletinin Zyrtar të Agjencisë.

KAPITULLI VII

NDRYSHIMET NË REGJISTËR

Neni 29

Regjistrimi i ndryshimeve në Regjistrin e Markave Tregtare

1. Aplikuesi ose pronari i markës tregtare mund të dorëzojë kërkesë për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin e Markave Tregtare, në pajtim me nenin 42 të Ligjit për Markat Tregtare.

2. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në regjistër përmban:

- 2.1. numrin e aplikimit ose regjistrimit;
- 2.2. emrin, adresën, dhe email të aplikuesit ose pronarit të një marke tregtare;

- 2.3. emrin, adresën dhe email të përfaqësuesit, nëse është caktuar;
 - 2.4. dëshmi për ndryshim sipas Ligjit për Markat Tregtare;
 - 2.5. të dhënat e qarta për llojin e ndryshimit dhe përshkrimin se si do të bëhet ndryshimi;
 - 2.6. nënshkrimin e aplikuesit ose përfaqësuesit të tij.
3. Vërtetimin e pagesës së taksës përkatëse.
4. Kur Agjencia konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për ndryshim të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, ajo e fton aplikuesin ose pronarin e markës tregtare që t'i plotësojë mangësitë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ftesës.
5. Me kërkesë të aplikuesit ose pronarit të markës tregtare, afati i përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni mund të vazhdohet më së shumti për tridhjetë (30) ditë.
6. Nëse mangësitë e konstatuara nga Agjencia nuk plotësohen në përputhje me paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni, Agjencia refuzon kërkesën për regjistrimin e ndryshimeve.
7. Nëse plotësohen mangësitë ose nuk ka pasur mangësi dhe kërkesa për ndryshim në regjistër është e arsyeshme, Agjencia nxjerr vendimin për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin e Markave Tregtare. Agjencia i publikon ndryshimet në Buletinin Zyrtar.
8. Kërkesa për ndryshim bëhet veçmas për çdo aplikacion apo regjistrim dhe paguhet taksë e veçantë për secilën kërkesë.
9. Ky nen zbatohet edhe me rastin e dorëzimit të kërkesës për përmirësimet në aplikacionet e markës tregtare.

Neni 30 **Bartja e së drejtës**

1. Kërkesa për bartjen e së drejtës përmban:
- 1.1. numrin e aplikimit ose regjistrimit;
 - 1.2. dëshmi për ndryshimin për bartje sipas neneve 17 deri 23 të Ligjit për Markat Tregtare;
 - 1.3. emrin, adresën dhe emailin e pronarit të ri të aplikimit ose të markës së regjistruar;
 - 1.4. emrin, adresën dhe email e përfaqësuesit, nëse pronari i ri ka caktuar një përfaqësues;
 - 1.5. kur bartja ka të bëjë vetëm me disa nga mallrat dhe shërbimet, listën e qartë dhe të saktë të mallrave dhe shërbimeve për të cilat kërkohet bartja e së drejtës;
 - 1.6. nënshkrimin e aplikuesit apo pronarit të markës tregtare ose përfaqësuesit, nëse ka të tillë;
 - 1.7. vërtetim për pagesën e taksës përkatëse.
2. Kur Agjencia konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për regjistrimin e bartjes, të përcaktuara në nenin 17 të Ligjit për Markat Tregtare, sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe në kërkesat e tjera që rregullojnë bartjen, Agjencia e fton aplikuesin ose pronarin e markës tregtare t'i plotësojë mangësitë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i kërkesës së tillë.

3. Me kërkesë të aplikuesit ose pronarit të markës tregtare, afati kohor mund të zgjatet më së shumti për tridhjetë (30) ditë.

4. Nëse mangësitë nuk plotësohen në përputhje me ftesën e Agjencisë ose nëse nuk plotësohen brenda afatit të përcaktuar kohor, Agjencia me vendim e refuzon kërkesën për bartje të regjistrimit.

5. Nëse plotësohen mangësitë ose nëse nuk ka pasur mangësi dhe kërkesa për regjistrimin e bartjes në regjistër është e arsyetuar, Agjencia nxjerr vendimin për regjistrimin e bartjes në Regjistrin e Markave Tregtare. Agjencia e publikon bartjen në Buletinin Zyrtar.

6. Për çdo bartje të së drejtës që i referohet dy ose më shumë regjistrimeve të të njëjtit pronar, bëhet një kërkesë e veçantë. Taksa e përcaktuar paguhet për çdo regjistrim të bartjes, veçmas.

Neni 31

Regjistrimi i të drejtave të pengut

1. Kërkesa për regjistrimin e të drejtës së pengut përmban:

1.1. numrin e aplikimit ose regjistrimit;

1.2. emrin, adresën dhe email të përfituesit të së drejtës reale;

1.3. emrin, adresën dhe email të përfaqësuesit të përfituesit, nëse është caktuar;

1.4. nënshkrimin e aplikuesit ose pronarit të markës tregtare ose nënshkrimin e përfaqësuesit, nëse është caktuar.

2. Kërkesa për regjistrimin e të drejtës së pengut shoqërohet me:

2.1. Dëshminë për përcaktimin e të drejtës së pengut në bazë të dispozitave të ligjit që rregullon të drejtat reale;

2.2. Vërtetim për pagesën e taksave të përcaktuara.

3. Kur Agjencia konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për regjistrimin e së drejtës pengut të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit për Markat Tregtare, sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni dhe në kërkesat e tjera që rregullojnë të drejtat e pengut për markën tregtare, ajo e fton aplikuesin ose pronarin e markës tregtare t'i korrigjojë mangësitë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ftesës.

4. Me kërkesë të aplikuesit ose pronarit të markës tregtare, afati mund të zgjatet për tridhjetë (30) ditë nga data e skadimit të atij afati kohor.

5. Nëse mangësitë e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk plotësohen në përputhje me ftesën e Agjencisë ose nëse nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, Agjencia me vendim e refuzon kërkesën për regjistrimin e të drejtës së pengut.

6. Nëse plotësohen mangësitë ose nuk ka pasur mangësi dhe arsyetohet kërkesa për regjistrim të së drejtës së pengut, Agjencia nxjerr vendimin për regjistrimin e të drejtës së pengut në Regjistrin e Markave Tregtare. Agjencia publikon të drejtën e pengut në Buletinin Zyrtar.

7. Për regjistrimin e së njëjtës të drejtë pengut lidhur me dy ose më shumë aplikime ose regjistrime të të njëjtit aplikues ose pronar të markës tregtare, bëhen kërkesa të veçanta. Taksa e përcaktuar paguhet për çdo të drejtë të pengut që duhet të regjistrohet.

Neni 32 **Regjistrimi i përmbartimit ose falimentimit**

1. Në bazë të dispozitave nga nenet 19 dhe 20 të Ligjit për Markat Tregtare, dhe me kërkesën e autoritetit kompetent, Agjencia regjistron masën përmbartimore ndaj aplikimit ose regjistrimit të markës tregtare ose se aplikuesi i markës tregtare apo pronari i një marke tregtare është i përfshirë në procedurë të falimentimit ose procedurë të ngjashme.

2. Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni përmban numrin e aplikimit ose regjistrimin e markës tregtare në fjalë dhe detajet e procedurës përmbartimore ose të falimentimit apo procedurave të ngjashme relevante për aplikimin ose regjistrimin e markës tregtare në fjalë.

3. Nëse plotësohen kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni, Agjencia nxjerr vendimin për regjistrimin e procedurës përmbartimore ose të falimentimit apo procedurës së ngjashme në Regjistrin e Markave Tregtare. Agjencia publikon në Buletinin Zyrtar

Neni 33 **Regjistrimi i licencave**

1. Kërkesa për regjistrim të licencës duhet të përmbajë:

1.1. numrin e regjistrimit;

1.2. emrin dhe adresën e personit fizik dhe juridik të licencuar;

1.3. emrin dhe adresën e përfaqësuesit të personit fizik dhe juridik të licencuar,

1.4. të dhënat për mallrat dhe shërbimet për të cilat është dhënë licenca në rastet, kur licenca është dhënë vetëm për disa nga mallrat dhe shërbimet,;

1.5. të dhënat për pjesën e territorit të Republikës së Kosovës për të cilat është dhënë licenca, në rastet kur licenca është dhënë vetëm për një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës;

1.6. të dhënat për periudhën kohore për të cilën është dhënë licenca, në rastet kur licenca është dhënë për një periudhë të afatizuar kohore;

1.7. të dhënat sipas licencës ekskluzive;

1.8. nënshkrimin e personit që paraqet kërkesën, ose nënshkrimin e përfaqësuesit të tij.

1.9. dëshmi të licencës në pajtim me nenin 17 paragrafin 3 të Ligjit për Marka Tregtare;

1.10. dëshmi për pagesën e tarifës përkatëse.

2. Kur Agjencia konstaton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim të licencës ashtu siç është përcaktuar në nenin 17 të Ligjit për Marka Tregtare, në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe kërkesat tjera që përcaktojnë licencën, ajo fton paraqitësin e aplikacionit të plotëson mangësitë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të ftesës.

3. Me kërkesë të paraqitësit të aplikacionit, afati kohor mund mund të zgjatet edhe tridhjetë (30) ditë.

4. Nëse mangësitë e përcaktuara sipas paragrafit 3 të këtij neni nuk plotësohen në pajtim me kërkesën e Agjencisë ose nëse ato nuk plotësohen brenda afatit të caktuar kohor, Agjencia refuzon kërkesën për regjistrim të licencës.

5. Për regjistrim të licencës së njëjtë lidhur me dy ose më shumë regjistrime të pronarit të njëjtë bëhen me kërkesa të veçanta. Tarifa përkatëse duhet të paguhet për secilën licencë veç e veç që kërkohet të regjistrohet.

6. Dispozitat e këtij neni gjithashtu vlejné për regjistrimin e licencës e cila jepet nga një i licencuar licenca e të cilit është regjistruar në Regjistrin e Markës Tregtare (nën-licencë).

Neni 34

Fshirja e të dhënave në regjistër

1. Regjistrimi i licencës, të drejtës së pengut, përmbarimit ose falimentimit ose procedurave tjera të ngjashme në të cilat është përfshirë marka tregtare anulohet me kërkesë të njërit nga personat e interesuar ose sipas procedurës ex-officio të Agjencisë.

2. Kërkesa për anulim nga paragrafi 1 i këtij neni përmbanë:

2.1. numrin e regjistrimit;

2.2. të dhënat e të drejtës mbi bazën e të cilës regjistrimi anulohet.

2.3. dëshmi që tregon se e drejta e regjistruar nuk ekziston më ose deklarata e të licencuarit ose pronarit të një të drejte tjetër për pajtimin e tij me anulimin e regjistrimit;

2.4. dëshmi për pagesën e tarifave përkatëse, kur kërkohet anulimi i regjistrimit të licencës ose të pengut.

3. Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen, pas aprovimit të ndryshimeve përkatëse, për kërkesën për ndryshim të regjistrimit të licencës, të drejtës së pengut, përmbarimit ose falimentimit ose procedurave të ngjashme në të cilat është përfshirë marka tregtare.

Neni 35

Vazhdimi i regjistrimit të markës tregtare

1. Kërkesa për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare përmbanë:

1.1. numrin e aplikimit dhe regjistrimit;

1.2. emrin dhe adresën e pronarit të markës tregtare;

1.3. emrin dhe adresën e përfaqësuesit, autorizimin nëse pronari ka përfaqësues;

1.4. kur kërkesa është parashtruar nga personi i autorizuar për ta bërë këtë nga pronari i markës tregtare, emrin dhe adresën e atij personi dhe dëshmi që tregon se ai është i autorizuar nga pronari i markës tregtare për të paraqitur kërkesën;

1.5. shënimin se a kërkohet vazhdimi për të gjitha klasat apo vetëm një apo disa nga klasat e markës së regjistruar;

1.6. nënshkrimin e personit që paraqet kërkesën, ose nënshkrimin e përfaqësuesit të tij.

2. Aplikacionit i bashkangjitet dëshmia e pagesës së tarifës përkatëse ose të tarifës së dyfishtë në rast të vazhdimit brenda periudhës shtesë gjashtëmuajore.

3. Kur kërkesa për vazhdim është paraqitur dhe tarifa përkatëse është paguar periudhës të përcaktuara në paragrafin 2, të nenit 46 të Ligjit për Marka Tregtare, por Agjencia konstaton se nuk janë përmbushur kushtet e tjera të aplikueshme për vazhdimin e regjistrimit ashtu siç janë përcaktuar në nenin 46 të Ligjit për Marka Tregtare dhe në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Agjencia fton paraqitësin e aplikacionit për të plotësuar mangësitë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të ftesës.

4. Nëse mangësitë e konstatuara nga Agjencia nuk plotësohen në pajtim me ftesën e Agjencisë, atëherë Agjencia me vendim refuzon kërkesën për vazhdim të markës.

5. Nëse nuk ka mangësi në kërkesën për vazhdim ose nëse ato mënjanohen, Agjencia nxjerr vendim për vazhdim dhe regjistron në regjistër se marka tregtare regjistrohet për një periudhë të re 10 vjeçare, duke llogaritur nga dita e skadimit të periudhës së mëparshme dhjetëvjeçare të regjistrimit të markës tregtare.

6. Agjencia publikon vazhdimin e markës tregtare në Buletinin Zyrtar.

Neni 36

Përfundimi i vlefshmërisë së markës tregtare

1. Marka tregtare e regjistruar përfundon në rastet e mëposhtme:

1.1. me skadimin e afatit dhjetëvjeçar të regjistrimit, nëse nuk vazhdohet;

1.2. nëse hiqet dorë nga marka tregtare;

1.3. nëse revokohet marka tregtare;

1.4. nëse marka tregtare është shpallur e pavlefshme.

2. Agjencia regjistron në Regjistrin e Markave Tregtare ndërprerjen e regjistrimit të markës tregtare dhe arsyen e ndërprerjes.

3. Agjencia publikon në Buletinin Zyrtar ndërprerjen e regjistrimit dhe arsyen e ndërprerjes.

Neni 37

Kërkesa për heqje dorë

1. Kërkesa për heqje dorë përmban:

1.1. kërkesa për heqje dorë të plotë ose të pjesshme të një marke tregtare nga Regjistri i Markave Tregtare;

1.2. numrin e regjistrimit;

1.3. emrin, adresën dhe emailin e pronarit të markës tregtare;

1.4. emrin, adresën dhe emailin e përfaqësuesit, nëse është caktuar;

- 1.5. kur heqja dorë deklarohet vetëm për disa nga mallrat dhe shërbime për të cilat është regjistruar marka tregtare, listën e mallrave dhe shërbimeve për të cilat marka tregtare mbetet e regjistruar.
2. Kur në regjistrë regjistrohet e drejta e një pale të tretë në lidhje me markën tregtare, kërkesa shoqërohet me deklaratën e pëlqimit të pronarit të kësaj të drejte nga e cila hiqet dorë, e nënshkruar prej tij ose përfaqësuesit të tij, apo dëshmi të tjera të përshtatshme që tregojnë se pronari i kësaj të drejte pajtohet me heqjen dorë.
3. Kur heqja dorë lidhet me markën tregtare të licencuar, deklarata shoqërohet me dëshmi që tregon se pronari i markës tregtare e ka njoftuar të licencuarin për qëllimin e tij për të hequr dorë nga marka tregtare në përputhje me nenin 47, paragrafi 3 i Ligjit për Markat Tregtare.
4. Nëse nuk plotësohen kushtet sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, Agjencia e fton pronarin e markës tregtare që t'i plotësojë mangësitë gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ftesës.
5. Nëse nuk mënjahohen mangësitë në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, Agjencia e refuzon deklaratën e heqjes dorë prej markës tregtare.
6. Nëse mënjahohen mangësitë ose nëse nuk ka pasur mangësi dhe kërkesa për regjistrim në regjistrë të heqjes dorë është e arsyeshme, Agjencia nxjerr vendimin për regjistrimin e heqjes dorë në Regjistrin e Markave Tregtare. Agjencia e publikon heqjen dorë në Buletinin Zyrtar.
7. Kërkesa e heqjes dorë prej regjistrimit të markës tregtare, së bashku me të gjitha dokumentet e bashkangjitura, i dorëzohet Agjencisë në dy (2) kopje.
8. Kërkesa e heqjes dorë për dy ose më shumë regjistrime të markave tregtare, dorëzohet veçmas për çdo regjistrim të markës tregtare.

Neni 38

Kërkesa për revokim të regjistrimit

1. Kërkesa për revokim të regjistrimit të markës tregtare përmban:

- 1.1. numrin e regjistrimit të markës tregtare;
- 1.2. emrin dhe adresën e pronarit të markës tregtare;
- 1.3. të dhënat e mallrave ose shërbimeve në lidhje me të cilat kërkohet revokimi;
- 1.4. emrin, adresën dhe emailin e personit që dorëzon revokimin, në pajtim me nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Markat Tregtare;
- 1.5. emrin, adresën dhe emailin e përfaqësuesit, nëse është caktuar;
- 1.6. arsyen në të cilën mbështetet kërkesa për revokim, në bazë të nenit 48 të Ligjit për Markat Tregtare;
- 1.7. të dhëna për faktet, argumentet dhe dëshmitë e dorëzuara për të mbështetur arsyet në të cilat bazohet revokimi, të shoqëruara me dokumentet relevante mbështetëse.
- 1.8. nënshkrimin e personit që dorëzon kërkesën për revokim ose të përfaqësuesit të tij, nëse është caktuar;
- 1.9. pagesën e taksës së përcaktuar.

2. Kërkesa për revokimin e regjistrimit të markës tregtare, së bashku me të gjitha dokumentet shoqëruese, i dorëzohet Agjencisë në dy (2) kopje.

3. Nëse i njëjti person kërkon revokimin për dy ose më shumë marka të të njëjtit pronar, duhet të paraqitet një kërkesë e veçantë për revokimin e secilës markë tregtare.

Neni 39

Shqyrtimi i kërkesave për revokim

1. Kërkesa e paraqitur për revokim shqyrtohet nga Agjencia nëse janë plotësuar kushtet e përcaktura në paragrafin 2 të nenit 37 të këtij Udhëzimi. Nëse Agjencia konstaton se këto kërkesa nuk janë përmbushur, me vendim e refuzon kërkesën për revokim.

2. Nëse kërkesa për revokim bazohet në mospërdorimin e markës së regjistruar tregtare sipas nenit 48 paragrafi 1 nën-paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Markat Tregtare, Agjencia gjithashtu shqyrton nëse kërkesa për revokim është parashtruar para skadimit të periudhës pesë (5) vjeçare nga regjistrimi i markës tregtare për të cilën kërkohet revokimi. Nëse Agjencia konstaton se këto kërkesa nuk janë përmbushur, me vendim e refuzon kërkesën për revokim.

3. Nëse Agjencia konstaton se janë përmbushur kërkesat sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, i dërgon pronarit të markës tregtare kopjen e kërkesës për revokim së bashku me të gjitha dokumentet e dorëzuara në Agjenci dhe e fton atë që të dorëzojë vërejtjet e tij për revokimin brenda dy (2) muajve nga pranimi i ftesës.

4. Me kërkesë të bartësit të markës tregtare, e cila bëhet brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, afati mund të vazhdohet edhe për dy (2) muaj nga data e skadimit të atij afati.

5. Nëse pronari i markës tregtare nuk i parashtron vërejtjet e tij për kërkesën për revokim brenda afatit të caktuar, regjistrimi i markës tregtare revokohet dhe Agjencia nxjerr një vendim për pranimin e kërkesës për revokim dhe e çregjistron markën tregtare nga Regjistri i Markave Tregtare. Vendimi publikohet në Buletinin Zyrtar të Agjencisë.

6. Në vërejtjet e tij për revokimin, pronari i markës tregtare mund të paraqesë detaje të fakteve, argumenteve dhe dëshmive në mbështetje të pretendimeve të tij kundër kërkesës për revokim, së bashku me dokumentet përkatëse mbështetëse, të bazuara në nenin 50 paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit për Markat Tregtare.

7. Nëse nga shqyrtimi i kërkesës për revokim rezulton se kërkesa për revokim është e pa arsyeshme, Agjencia e refuzon kërkesën me vendim. Vendimi për refuzimin e revokimit i dërgohet si aplikuesit ashtu edhe pronarit të markës tregtare.

8. Nëse nga shqyrtimi i kërkesës për revokim konstatohet se kërkesa për revokim është e arsyeshme për të gjitha mallrat ose shërbimet e përfshira në regjistrim, kërkesa për revokim pranohet dhe regjistrimi revokohet.

9. Nëse nga shqyrtimi i kërkesës për revokim konstatohet se kërkesa për revokim është e arsyeshme vetëm lidhur me një pjesë të mallrave ose shërbimeve të përfshira në regjistrim, regjistrimi i markës tregtare revokohet vetëm për ato mallra dhe shërbime.

Neni 40

Kërkesa për shfuqizimin e markës tregtare

1. Për çdo regjistrim të markës tregtare bëhet kërkesë e veçantë për deklarim të shfuqizimit të markës tregtare. Nuk lejohet kërkesë e përbashkët për shfuqizim për disa markave tregtare të regjistruara. Kërkesat e tilla, me vendim të Agjencisë konsiderohen si jo të parashtruara.

2. Kërkesa për deklarim të shfuqizimit të markës tregtare përmban:

2.1. numrin e regjistrimit të markës tregtare për të cilën kërkohet deklarimi i shfuqizimit;

2.2. emrin dhe adresën e pronarit;

2.3. të dhënat e mallrave ose shërbimeve lidhur me të cilat kërkohet shfuqizimi i markës tregtare. Nëse nuk ceket se cilat mallra dhe shërbime nga lista e mallrave dhe shërbimeve, konsiderohet se kërkesa për shfuqizim ka të bëjë me të gjitha mallrat ose shërbimet e markës tregtare kundrejt të cilave është parashtruar kërkesa për shfuqizim;

2.4. emrin, adresën, emailin e paraqitësit kërkesës për deklarim të shfuqizimit, në pajtim me nenin 53 të Ligjit për Markat Tregtare;

2.5. emrin, adresën, emailin e përfaqësuesit, nëse ka të tillë;

2.6. bazën ligjore për parashtrimin e kërkesës për deklarimin e markës tregtare si të pavlefshme;

2.7. të dhënat e shkaqeve, fakteve dhe argumenteve në të cilat bazohet kjo kërkesë;

2.8. nënshkrimin e personit që parashtron kërkesën ose të përfaqësuesit të tij, nëse është caktuar;

2.9. Vërtetim për pagesën e taksës së përcaktuar.

3. Kërkesa për shfuqizimin e markës tregtare mund të përmbajë detaje të tjera të fakteve, argumenteve dhe dëshmive të paraqitura së bashku me dokumentet relevante mbështetëse.

4. Kërkesa për deklarimin e shfuqizimit të markës tregtare, së bashku me të gjitha dokumentet përcjellëse, i dorëzohet Agjencisë në dy (2) kopje.

5. Neni 18 i këtij Udhëzimi Administrativ zbatohet mutatis mutandis për kërkesat për shfuqizimin të parashtruara sipas nenit 53 paragrafi 1 nën-paragrafët 1.2 deri 1.6. Ligjit për Markat Tregtare

Neni 41

Shqyrtimi i kërkesave për shfuqizim

1. Agjencia shqyrton kërkesat për deklarimin e shfuqizimit të markës tregtare dhe konstaton nëse kërkesa është parashtruar në përputhje me nenin 52 të Ligjit për Markat Tregtare dhe nëse janë plotësuar kushtet sipas paragrafit 2 të nenit 40 të këtij Udhëzimi Administrativ. Nëse Agjencia konstaton se këto kërkesa nuk janë përmbushur, me vendim e refuzon kërkesën për shfuqizim.

2. Nëse Agjencia konstaton se janë përmbushur kërkesat sipas paragrafit 1 të këtij neni, kopjen e kërkesës për shfuqizim së bashku me të gjitha dokumentet e dorëzuara në Agjenci ia dërgon

pronarit të markës tregtare dhe e fton atë që të dorëzojë vërejtjet e tij për kërkesën për shfuqizim marke dy (2) muajsh nga pranimi i ftesës.

3. Me kërkesën e pronarit të markës tregtare, e cila bëhet brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, afati mund të vazhdohet edhe për dy (2) muaj, me kusht që të paguhet taksën përkatëse.

4. Nëse pronari i markës tregtare nuk i parashtron vërejtjet e tij për kërkesën për shfuqizim brenda afatit të caktuar, regjistrimi i markës tregtare bëhet i pavlefshëm dhe Agjencia nxjerr vendim për aprovimin e kërkesës për shfuqizim dhe fshirjen e regjistrimit të markës tregtare nga Regjistri i Markave Tregtare. Vendimi publikohet në Buletinin Zyrtar të Agjencisë.

5. Në vërejtjet e tij për shfuqizim, pronari i markës tregtare mund të paraqesë detaje të fakteve, argumenteve dhe dëshmime në mbështetje të pretendimeve të tij kundër kërkesës për shfuqizim, së bashku me dokumentet përkatëse. Pronari i markës tregtare duhet të paraqet dëshmi për vërtetimin e përdorimit të markës tregtare në pajtim me nenin 55 të Ligjit për Markat Tregtare dhe nenin 20 të këtij Udhëzimi Administrativ.

6. Nëse nga shqyrtimi i kërkesës për shfuqizim rezulton se kërkesa është e paarsyeshme Agjencia e refuzon kërkesën me vendim.

7. Nëse nga shqyrtimi i kërkesës për shfuqizim rezulton se kërkesa për shfuqizim është e arsyeshme për të gjitha mallrat ose shërbimet e përfshira në regjistrim, kërkesa për shfuqizim pranohet dhe regjistrimi bëhet i pavlefshëm.

8. Nëse nga shqyrtimi i kërkesës për shfuqizim rezulton se kërkesa është e arsyeshme vetëm në lidhje me një pjesë të mallrave ose shërbimeve, regjistrimi i markës tregtare bëhet i pavlefshëm vetëm për ato mallra ose shërbime për të cilat vërtetohet se kërkesa për shfuqizim është e arsyeshme. Në vendimin për shfuqizim, Agjencia i liston shprehimisht mallrat dhe shërbimet për të cilat marka tregtare bëhet e pavlefshme dhe listën e mallrave dhe shërbimeve për të cilat regjistrimi mbetet në fuqi.

9. Vendimet sipas paragrafëve 5, 6 dhe 7 të këtij neni arsyetohen sipas nenit 53 të Ligjit për Markat Tregtare. Agjencia ia dërgon vendimin aplikuesit ashtu edhe pronarit të markës tregtare.

KAPITULLI VIII

RREGULLORE E BRENSHME E PRONARËVE QË RREGULLOJNË PËRDORIMIN E MARKAVE KOLEKTIVE DHE CERTIFIKUESE

Neni 42

Përmbajtja e Rregullores së brendshme të pronarëve që rregullojnë përdorimin e markave kolektive

1. Përmbajtja e Rregullores së brendshme të pronarëve që rregullojnë përdorimin e markave kolektive sipas nenit 61 paragrafi 2 i Ligjit për Markat Tregtare përmbanë:

- 1.1. emrin e aplikuesit;
- 1.2. qëllimin e asociimit ose qëllimin për të cilin është krijuar një person juridik;
- 1.3. autoritetet e autorizuar për të përfaqësuar një shoqatë ose një person juridik;
- 1.4. në rastin e asociimit, kushtet e anëtarësimit në shoqatë;
- 1.5. dukja e markës kolektive;
- 1.6. personat e autorizuar për ta përdorur një markë kolektive;
- 1.7. sipas nevojës, kushtet që rregullojnë përdorimin e një marke kolektive, duke përfshirë sanksionet;
- 1.8. mallrat ose shërbimet të përfshira nga një markë tregtare kolektive, aty ku është e zbatueshme, të gjitha kufizimet e paraqitura.

Neni 43

Përmbajtja e Rregullores së brendshme të pronarëve që rregullojnë përdorimin e markave certifikuese

1. Përmbajtja e Rregullores së brendshme të pronarëve që rregullojnë përdorimin e markave certifikuese sipas nenit 61 paragrafi 3 i Ligjit për Markat Tregtare përmbanë:

- 1.1. emrin e aplikuesit;
- 1.2. dukjen e markës tregtare certifikuese;
- 1.3. mallrat ose shërbimet për markë tregtare certifikuese;
- 1.4. karakteristikat e mallrave ose shërbimeve të certifikuar nga një markë tregtare certifikuese, si materiali, mënyra e prodhimit të mallrave, mënyra e dhënies së shërbimeve, cilësia apo korrektësia;
- 1.5. kushtet që rregullojnë përdorimin e markës tregtare certifikuese, duke përfshirë sanksionet;
- 1.6. personat e autorizuar për ta përdorur një markë certifikuese, mënyrat si duhet t'i testojë organi certifikues ato karakteristika dhe ta mbikëqyrë përdorimin e një marke certifikuese.

KAPITULLI IX DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 44 Emri dhe adresa

1. Kërkesat për regjistrimin e markës tregtare si dhe të gjitha kërkesat e tjera të paraqitura në Agjenci sipas Ligjit për Marka Tregtare, përfshijnë emrin dhe adresën e aplikuesit dhe përfaqësuesit të tij, nëse është caktuar, si në vijim:

- 1.1. nëse aplikuesi ose përfaqësuesi është person fizik: emrin dhe mbiemrin e aplikuesit ose përfaqësuesit, adresën, web faqen, emailin dhe numrin kontaktues;

1.2. nëse aplikuesi ose përfaqësuesi është person juridik: emërtimin e plotë zyrtar të aplikuesit ose përfaqësuesit, adresën, web faqen, emailin dhe numrin kontaktues.

2. Adresa tregohet në mënyrë të tillë që të plotësojë kërkesat e zakonshme për dërgimin e shpejtë postar në adresën e treguar.

3. Aplikuesi dhe përfaqësuesi janë përgjegjës për ta mbajtur të informuar Agjencinë për çdo ndryshim në adresën e tyre. Adresa e fundit postare e aplikuesit ose e përfaqësuesit të tij konsiderohet adresa e tyre. Aplikuesi dhe përfaqësuesi nëse nuk e informojnë Agjencinë për çdo ndryshim të adresës së tyre ose kanë paraqitur adresë të gabuar, Agjencia konsideron se dokumentet i janë dorëzuar palës.

4. Në rastet kur shënohen disa adresa të aplikuesit ose përfaqësuesit të tij, merret parasysh vetëm adresa e parë e përmendur, me përjashtim të rastit kur aplikuesi ose përfaqësuesi shënon një nga adresat si adresë për korrespondencën.

Neni 45

Përfaqësuesit e përbashkët

1. Nëse ka më shumë se një aplikues për regjistrimin e markës tregtare ose ka një apo më shumë pronar të përbashkët të markës tregtare që parashtrajnë bashkërisht një kundërshtim ose kërkesë për revokim apo deklaram për shfuqizim, atëherë këta aplikues, pronarë e autorizojnë përfaqësuesin e tyre të përbashkët.

2. Nëse nuk është caktuar përfaqësuesi i përbashkët, aplikuesi, pronari i caktuar së pari Konsiderohet si përfaqësues i përbashkët. Nëse njëri prej këtyre aplikuesëve, pronarëve ka caktuar një përfaqësues të autorizuar, atëherë përfaqësuesi i tillë i autorizuar konsiderohet si përfaqësues i përbashkët.

3. Nëse më shumë se një aplikues, pronar kanë caktuar një përfaqësues të autorizuar, përfaqësuesi i autorizuar i caktuar së pari nga aplikuesi, pronari konsiderohet si përfaqësues i autorizuar.

Neni 46

Komunikimi dhe dorëzimi i dokumenteve në Agjenci

1. Dokumentet dhe komunikimet e tjera duhet të dorëzohen në Agjenci në formë fizike ose në rastet kur kërkohet nga Agjencia dhe në formë elektronike.

2. Aplikimi për regjistrimin e markës tregtare dhe të gjitha aplikimet e tjera, kërkesat, dokumentet apo komunikimet e tjera i dorëzohen Agjencisë, siç përcaktohet në këtë Udhëzim Administrativ.

3. Aplikimi për regjistrimin e markës tregtare ose çdo aplikim, kërkesë, dokument apo komunikim tjetër për Agjencinë, dorëzohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Publikimet në Buletin Zyrtar të Agjencisë bëhen në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 47

Aplikacionet

1. Agjencia përgatit aplikacionet e mëposhtëm:

- 1.1. aplikacion për regjistrimin e markës tregtare;
- 1.2. aplikacion për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare;
- 1.3. kërkesë për regjistrimin e një ndryshimi në Regjistrin e Markave Tregtare.

2. Aplikacionet e referuara në paragrafin 1 i këtij neni përdoren edhe për qëllimin e parashtrimit të kërkesës për regjistrimin e bartjes së markës tregtare, licencës, të drejtës së pengut, përmbarimit, falimentimit, lëshimit të certifikatës, kërkimit në bazën e të dhënave të Agjencisë, lëshimit të ekstraktit, heqjes dorë nga marka tregtare, kërkesës për revokim të markës tregtare, deklaramit të pavlefshmërisë, parashtrimit të kërkesës për të drejtën e përparësisë, ndërprerjes së vlefshmërisë, kufizimit të listës së mallrave dhe/ose shërbimeve, ndarjen, kthimit në pozitën fillestare apo procedurave të ngjashme në të cilat përfshihet marka tregtare.

3. Aplikacionet sipas në paragrafin 1 të këtij neni vihen në dispozicion në ueb faqen e Agjencisë.

Neni 48

Korrigjimi i pasaktësive dhe gabimeve

1. Kur publikimi i aplikimit, regjistrimi i markës tregtare ose publikimi i regjistrimit përmban një pasaktësi ose gabim që i atribuohet Agjencisë, Agjencia e korrigjon gabimin me iniciativën e saj ose me kërkesë të palës së interesuar.

2. Korrigjimet e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni publikohen në Buletinin Zyrtar.

Neni 49

Aplikimi për procedurat për ankesa

1. Për të gjitha çështjet që lidhen me procedurat për ankesa kundër vendimeve të Agjencisë në pajtim me nenin 68 të Ligjit për Markat Tregtare, ky Udhëzim Administrativ zbatohet në përputhje me të.

2. Pas nxjerrjes të vendimit të Komisionit të shqyrtimit të ankesave ndaj vendimeve të API-së, API brenda 60 ditëve të pranimit të vendimit të komisionit, duhet të rishqyrtoj aplikacionin dhe të merr vendim.

Neni 50

Zbatimi i ligjit të përgjithshëm për procedurën administrative

Të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me Ligjin për Markat Tregtare dhe me këtë Udhëzim Administrativ dhe të cilat u referohen çështjeve procedurale që lidhen me markat tregtare, rregullohen me ligjin e përgjithshëm për procedurën administrative.

Neni 51
Ekstraktet nga Regjistri

Me kërkesën e palës Agjencia lëshon ekstrakte nga Regjistri pas pagesës së taksës përkatëse

KAPITULLI X
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 52
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2016 për Regjistrimin e Markave Tregtare.

Neni 53
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Rozeta HAJDARI

Ministre e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Datë: 03.08.2023